



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**GJUHA E EMOTIKONEVE DHE VARIETET DIALEKTORE E
SHOQËRORE TË PËRDORIMIT TË SHQIPES NË MESAZHET
ELEKTRONIKE**

Kandidati:

Ardita Jashari

Mentor:

Prof. dr. Mustafa Ibrahim

**Tetovë,
2019**

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
LËNDA E HULUMTIMIT	6
QËLLIMET E HULUMTIMIT	6
HIPOTEZAT	7
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	8
RËNDËSIA E PUNIMIT	10
 Kreu i parë	14
GJUHA DHE INTERNETI	14
1. Interneti	15
1.1. Përhapja dhe përdorimi i gjuhës standarde në internet	16
1.2. Përhapja dhe përdorimi i emotikoneve, varieteteve dialektore dhe shoqërore në internet	18
 Kreu i dytë	20
FJALËT DHE SHENJAT MË TË PËRDORURA NË KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE	20
1. Fjalët dhe emotikonet më të përdorura në komunikimet elektronike	21
2. Gjuha e porosive nëpërmjet postës elektronike	23
3. Gjuha e mesazheve elektronike në sms.....	25
4. Gjuha e mesazheve elektronike të telefonisë celulare.....	26
 Kreu i tretë	28
PËRDORIMI I AKRONIMEVE NË KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE	28
1. Përdorimi i shkurtesave në komunikimet elektronike	29
2. Fjalëteshkurtuara në <i>Whats App</i>	31
3. Fjalët e shkurtuara në Viber.....	33
4.Fjalëte shkurtuara në sms (Shërbimi i Mesazheve tëShkruara – SMS)	36
3.4.Fjalëte shkurtuara në msn	37

Kreu i katërt	38
PËRDORIMI I EMOTIKONEVE NË KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE.....	38
1.Përdorimi i emotikoneve në komunikimet elektronike.....	39
2.Karakteristikat e përdorimit të shenjave dhe simboleve	40
3. Përdorimi i shenjave në komunikimet elektronike.....	49
Shenjat që më shpesh përdoren në komunikime elektronike.....	54
Anketimi që lidhet me përdorimin e shenjave dhe emotikoneve në porositë elektronike	56
 Kreu i pestë.....	60
RAPORTI GJUHË STANDARDE – E FOLMJA URBANE	60
Anketimi i raportit gjuhë standarde e folme urbane.....	64
Konkluzionet e anketimit	76
 PËRFUNDIMI	78
 LITERATURA	82
 SHTOJCA.....	85
Anketimi 1	85
Anketimi 2	86

MIRËNJOHJE

Për realizimin e kësaj teze masteri dua të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen për mentorin tim prof. dr. Mustafa Ibrahimin i cili ndihmoi në mënyrë të pakursyer me profesionalizmin e tij të lartë akademik, pranoi të më drejtonte dhe më ndihmoi për strukturimin e temës. I jam mirënjohëse për sugjerimet që më ka dhënë për çështje të ndryshme dhe mënyrën e këndvështrimit të tyre, literaturën e pasur që më ka nxitur ta përdor, më ka siguruar, si dhe shpjegimin e paqartësive e pyetjeve të cilat më lindën gjatë punimit të temës. Falënderoj katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Gjuhëve , Kulturave dhe Komunikimit në UEJL, për miratimin e kësaj teze masteri , për ndihmën e pakursyer dhe dashamirësinë ndaj kërkesave tona. Mirënjohje për miken time Donika Bakiun që më ka dhënë ndihmë gjithmonë. Falenderim dhe mirënjohje e pakufishme dhe për familjen time, e cila më nxiti dhe më inkurajoi vazhdimisht, duke më krijuar gjithë hapësirat e duhura, për t'ja dalë mbanë kësaj detyre të vështirë. Për të gjithë faleminderit !

PARATHËNIE

Gjatë studimeve të mia në programin 3+ 2 drejtimin gjuhë dhe letërsi shqipe në UEJL, shihja veten më shumë tek lënda e sociolingustikës , këtë lëndë e ndoqa në vitin e dytë të studimeve tre vjeçare dy semstra dhe në studimet master një semestër nga Prof.dr.Mustafa Ibrahim i njërherit mentor në tezën time të masterit . Sociolinguistika, “studimi i gjuhës në raport me shoqërinë”, është një disiplinë deri diku e re: hulumtimet e para të rëndësishme të William Labov-it përkrijnë me vitet ‘60. Megjithatë, rezultatet e arritura në këtë fushë hodhën dritë nga njëra anë mbi çështje të rëndësishme praktike (për shembull, rendimenti i ulët shkollor i fëmijëve nga shtresat e skamurës); nga ana tjetër, mbi probleme teorike delikate, si për shembull, modalitetet e procesit të standardizimit. ‘Gjuha e emotikoneve dhe varietetet dialektore shoqërore të përdorimit të shqipes në mesazhet elektronike’ është titulli i kësaj teze masteri për këtë nuk kam studiuar vetëm gjatë kësaj periudhe por ka vite që kur nisa studimet master . Materialet që do të paraqiten janë shumë interesante ,kam antekuar të rinjtë , kam marrë përgjigjet e tyre të cilat janë paraqitur në tezën e masterit. Në këtë punim kemi hyrjen , më pas kemi Kreun e parë ku flasim për :Gjuha dhe internet,Përhapja dhe përdorimi i gjuhës standarde në internet, Përhapja dhe përdorimi i emotikoneve, varieteteve dialektore dhe shoqërore në internet.Në Kreun e dytë kemi :Fjalët dhe emotikonet më të përdorura në komunikimet elektronike,Gjuha e mesazheve elektronike nëpërmjet *postës elektronike*,Gjuha e mesazheve elektronike në *sms*, Gjuha e mesazheve elektronike të telefonisë celulare . Në Kreun e katër kemi: Përdorimi i shkurtesave në komunikimet elektronike,Fjalët e shkurtuara në *Whats App*, Fjalët e shkurtuara në *Viber*,Fjalët e shkurtuara në *sms*, Fjalët e shkurtuara në *msn*. Në Kreun e pestë kemi:Përdorimi i shenjave në komunikimet elektronike ,Karakteristikat e përdorimit të shenjave dhe simboleve,Krahasimi gjuhësor dhe analiza e gabimeve,Vështrim ndaj nocionit „Gabim”,Shkaktar të mundshëm të gabimeve,Roli i krahasimit gjuhësor në analizën e gabimeve. Më pas kemi hulumtimin empirik pra vërejtje , rezultate, më pas është rezymja dhe interpretimi i rezultateve , në fund paraqitet literature e shfrytëzuar

LËNDA E HULUMTIMIT

Lënda e hulumtimit të këtij punimi të magistraturës e përfshin procesin e përhapjes dhe ndikimit të Internetin në gjuhën shqipe. Viteve të fundit janë krijuar ueb faqe të shumta në gjuhën shqipe, softuerë për të lehtësuar përdorimin e shqipes e deri te sistemet e fundit operative Windows, të cilat janë përkthyer në gjuhën shqipe, duke e lehtësuar në masë të madhe edhe futjen e shqipes nën strehën e Internetit dhe duke lehtësuar përdorimin e kompjuterëve dhe Internetit edhe për shqipfolës, të cilët nuk e njohin gjuhën angleze, apo ndonjë gjuhë tjetër të huaj. Shumë faktorë ndikuan në vendimmarrjen time që teza e magistraturës dhe lënda e hulumtimit tim t'ia dedikoj përdorimit të gjuhës shqipe dhe emotikoneve në internet. Mes tjerash ndikim të konsiderueshëm kishte dhe lënda sociolinguistikë dhe linguistika kompjuterike të cilat më mundësuan të jem në kontakt të dejtpërdrejt me këtë problematikë dhe në veçanti përvoja ime si studente e gjuhës shqipe (gjatë procesit të punimeve seminarike), por jo dhe faktor më pak i rëndësishëm, është mentori im, i cili ishte inspirimi im dhe përkrahësi gjatë gjithë studimit tim. Kjo temë nuk është interesante vetëm për realizim, por gjithashtu është edhe aktuale, për arsye se është fakt se të gjithë sot e përdorin internetin. Nga ana tjetër, në kohën e sotme është shumë lehtë të komunikohet në mënyra të ndryshme të komunikimit më lehtë të komunikohet për dallim nga e kaluara, kur është shënuar mungesë e teknologjisë e cila do të mundëson qasje të lehtë deri tek informacioni i kërkuar. Mirëpo ky zhvillim kaq rapid i teknologjisë na imponon një kulturë tjetër të përdorimit të gjuhës shqipe në internet, dhe gjithësesi parashtrohet pyetja: „Vallë teknologjia dhe kompjuteri janë të mjaftueshëm që një individë pa vështirësi të mund ta përdor gjuhën standard shqipe në të gjitha llojet e komunikimit?“.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Kjo tezë magistrature ka për qëllim përmes një hulumtimi t'u përgjigjet shumë pyetjeve siç janë:

1. Në veçanti fokusimi përqëndrohet në përdorimin e emotikoneve, problemet gjuhësore dhe varietetet dialektore dhe shoqërore gjatë përdorimit të shqipes në të gjitha fushat e aktivitetit në Internet, duke përfshirë ueb faqet, email-ët, dhomat e bisedave (chat rooms) dhe ndërveprimet përmes lojërave në Internet, mesazhet e çastit (instant

messaging), si dhe duke përfshirë fushat e tjera të ndërlidhura të komunikimit të ndërmjetuar me kompjuter (CMC, computer-mediated communication).

2. Interneti ka krijuar një domen të ri për përdorimin e shqipes, një domen elektronik e virtual.
3. Shqipja në Internet shfaqet në të gjitha format dhe stilet e saj, ashtu siç përdoret edhe në botën reale, ndërsa Interneti ka ndikuar në shfaqjen e varieteteve të reja të shqipes, për të cilat do të flasim më poshtë.
4. Krahas shqipes standarde, sot gjejmë të përdorur në Internet edhe varietetet e tjera gjeografike e shoqërore të shqipes.
5. Vallë gjatë përdorimit të gjuhës shqipe dhe emotikoneve në internet ndodhin tek përdoruesit gabime gjuhësore si pasojë e interferencave gjuhësore?
6. Të saktësohen gabimet gjuhësore dhe varietetet dialektore si pasojë e interferencave gjuhësore nga lëmia e morfologjisë dhe sintaksës dhe të njëjtat të analizohen.
7. Të analizohen dhe theksohen dallimet strukturale ndërmjet gjuhës amtare dhe dialekteve dhe ndikimi reciprok i tyre.
8. Të definohen dhe përkufizohen nocionet bazë të lidhura me temën dhe lëminë e hulumtimit.
9. T'u jepet vështrim i shkurtër teorive të shkenctarëve të ndryshëm të cilët kanë hulumtuar në temën e procesit të mësimi të gjuheve të huaj dhe zhvillimit të tyre.
10. Të theksohet rëndësia dhe roli i temës në këtë tezë magjistrature në shoqërinë bashkëkohore.

HIPOTEZAT

- Shqipja standarde, si kod formal, sot, haset kryesisht në ueb faqe të institucioneve qeveritare e publike në Shqipëri, Kosovë dhe në Maqedoni, në ueb faqe informative, pra të medieve të ndryshme në gjuhën shqipe, në ueb faqe që kanë për qëllim biznesin dhe, në më pak raste, edhe në ueb faqe që kanë për qëllim argëtimi.
- Në ueb faqe të ndryshme, ajo përdoret më shumë në formën e shkruar, por edhe në formë audio-vizuele, përmes audio/video materialeve. Sa i përket respektimit të

normës standarde, edhe në Internet i gjejmë po ato probleme të zbatimit të normës, të cilat i gjejmë edhe në botën reale (për disa nga shkeljet e normës në ueb faqet zyrtare të institucioneve të Kosovës shih: Munishi, 2006: 139-141).

- Aktivitetet ndërvepruese në Internet shfaqet variacioni i plotë gjuhësor i shqipes. Në dhomat e bisedave (chat rooms), në format e komunikimit përmes mesazheve të çastit në mesenxherë (messenger instant messaging) dhe format e tjera të komunikimit të ndërmjetuar me kompjuter (CMC) shqipja del në të gjitha variantet e saj gjeografike, por edhe në formë të kodeve shoqërore, disa prej të cilëve mund të quhen regjistra të veçantë, siç është p.sh. komunikimi me mesenxher.
- Pra, variacioni gjuhësor do të ketë një shtrirje të gjerë. Përveç kësaj, do të ndeshen edhe dukuri të tilla si ndërrimi i stilit, pra ndodh që në rastet e caktuara të ketë përshtatje të stilit dhe në raste të tilla kemi lëvizje drejt anët formale të spektrit stilistikë dhe anasjelltas, varësisht nga vëmendja që i kushtohet ligjëritimit të individit.
- Kombinimi i rezultateve empirike dhe konstatimet nga pjesa teorike do të rezultojnë me sqarime të esencës së fenomenit interferenca gjuhësore, si dhe mundësia e mungesës së saj.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

1. BURIMET E LITERATURËS

- *burimi primar* – Internet
- *burimi sekundar* - Biblioteka Univesitare

2. PJESËMARRËS

Grupi target për këtë hulumtim janë hapësirat mbarëshqiptare të komunikimit në internet (dhomat e chat-it; në mesenxherë) mund të hasen varieteti i Tiranës, i Prishtinës, i Shkupit i Tetovës, ose edhe ai i Shkodrës.

METODAT DHE PROCEDURA

Natyra e kësaj teze magjistrature më inponon përdorimin e metodave bazë (dedukcioni dhe indukcioni). Përveç këtyre metodave, metoda tjera që do ti përdori janë:

- *metoda hulumtuese* – Do të hulumtohen të gjitha ueb faqet për riprodhimin e plotë në formë të shkruar të formës së folur, ku do të hasen forma të ndryshme si: bon (bën), du (dua), mir (mirë), koma (këmba), ene (edhe), kokshna (qenkam), pra forma të cilat individ i përdor në të folurit e tij të zakonshëm, aka diqka (për a ka diçka), pom doket (po me duket), si dhe prirja për t'i shkruar format që shkruhen me apostrof pa apostrof (sdi ose zdi në vend të s'di, skam në vend të s'kam), nuk bëhet fare dallimi midis grafemave ç/q dhe kryesisht fjalët shkruhen me q (veq në vend të veç) dhe e në vend të ë dhe kjo ndodh për arsye praktike, pasi që në tastierat e zakonshëm në gjuhën latine nuk ka ç dhe ë dhe këto shkronja duhet të zëvendësohen me simbole. Vërehet mospasqyrimi në shkrim i ë-së së patheksuar dhe shkruhen mir e un në vend të mirë dhe unë, si dhe zëvendësimi i fjalës (numrit, nyjës) një-ni me numrin 1, p.sh. spo muj 1 her. Poashtu, ka prirje për përdorimin e shkurtesave të qyteve e vendeve, jo vetëm shqiptare, por edhe atyre të huaja, si psh: pr (Prishtina), gl (Gjilani), te (Tetova), ny ose nyc (New York City), be (Berni), zh (Gjenevë), ch (Zvicër), de (Gjermani) etj.
- Një riprodhim të qëndrueshëm kanë edhe pasthirrat dhe, përveç emotikonëve, edhe format e shkruara që synojnë të paraqesin gjendjen emocionale të bashkëbiseduesve, si p.sh.: hahaha (të qeshur), mmmm (për të shprehur kënaqësi a shije), hmmm (dyshim a mendim), ufaaa (për të shprehur lodhje), pihh (për të shprehur neveri), jaak (për të shprehur gërdi) etj.
- Në anën tjetër, vlen të theksohet se kjo formë e komunikimit është e ndikuar mjaft nga anglishtja. Ndryshimi i kodit haset shpesh, sidomos kalimi nga shqipja në anglishte, ose ndonjë gjuhë tjetër (gjermanisht, italisht etj.). P.sh: ok (në rregull, mirë), np (no problem – s'ka problem), brb (be right back- kthehem menjëherë), lol (laughing out loud - qesh me të madhe), yeah (yes- po), ehazz up (ehats up - ç'kemi), u (you - ti), u 2 (you too - ti gjithashtu), 4 u (for you- për ty) etj.
- *metoda deskriptive* – do të orvatem, përmes definicioneve, sqarimeve dhe hulumtimeve të tjerë autorëve, t'i prezentoj dhe përkufizoj nocionet bazë të cilat kanë të bëjnë me këtë temë. Rezultatet e hulumtimeve të mija, gjashtu do të përshkruhen dhe sqarohen.
- *metoda analitike* – me ndihmën e kësaj metode rezultatet e hulumtimeve të mija dhe rezultatet e gjithë materialit të mbledhur do të analizohen, ndërsa më kryesorët do të prezantohen në punimin e magjistraturës.
- *metoda krahasuese*- do të realizohet një analizë krahasuese e rezultateve.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Ky hulumtim ka vlerë të madhe, para së gjithash, për vetë faktin se ajo trajton një temë mjaft aktuale, të cilës gjer më tani në kulturën shqiptare nuk i është dhënë rëndësi të mjaftueshme dhe nuk është hulumtuar në sasi të mjaftueshëm. Shkaku kryesor për këtë është përdorimi i emotikoneve dhe gjuhës shqipe në internet.

Nga ana tjetër, përmes këtij hulumtimi do të prezantohen dallimet kryesore fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore mes gjuhës gjuhës standarde shqipe dhe varieteteve dialektore dhe shoqërore. Veç asaj do të zbulohen se sa e dëmtojnë gjuhën përdorimi i emotikoneve, do të analizohen dhe sqarohen vështirësitë gjuhësore të përdoruesve nga të gjitha trevat shqiptare. Për këtë shkak është me rëndësi esenciale që përdoruesit të njftoheshin me këtë problematikë, për shkak se vetëm në atë mënyrë gjatë procesit të komunikimit mund të përdoret drejt gjuha standarde shqipe.

Meqë sot shqiptarët, duke iu falënderuar Internetit, mund të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe me familjarët e tyre qofshin ata në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, apo në diasporë, përdorimi i një gjuhe të pastër, qoftë në format e komunikimit me zë e pamje përmes videokonferencave mund të ndihmojë një unifikimin e gjuhës standard pa marrë parasysh ku jetojnë.

Interneti mund të ndihmojë edhe në ruajtjen e varieteteve të rrezikuara të shqipes, siç janë arvanitishtja dhe arbërishtja. Duke qenë mjet i komunikimit global, Interneti mund të ndihmojë në afrimin dhe në vendosjen e ndërkommunikimit midis folësve të arbërishte dhe të arvanitishtes me botën tjetër shqiptare. Kjo do të mund të ndihmonte në ruajtjen nga zhdukja të këtyre varieteteve të shqipes.

Ky punim magjistrature dhe hulumtimi i tij mund të jenë pjesë e librit ose i skriptës, e cila nuk do të jetë e përkushtuar vetëm për studentët apo intelektualët, por edhe për individë tjerë të cilët janë para së gjithash në kontakt të drejtpërdrejt me gjuhën shqipe. Prej kësaj del imperativi i tij përfundimtar- të shërbejë si material informues me atë t'jua lehtësojë përdorimin e gjuhës shqipe dhe shmangie nga format e gabuara në internet.

HYRJA

Lënda e hulumtimit të këtij punimi të magjistraturës e përfshin procesin e përhapjes dhe ndikimit të internetit në gjuhën shqipe, duke përdorur emotikone, fjalë të shkurtuara, akronime etj. Edhe pse, viteve të fundit janë krijuar ueb faqe të shumta në gjuhën shqipe, softuerë për të lehtësuar përdorimin e shqipes e deri te sistemet e fundit operative Windows, megjithatë të rinjtë vazhdojnë të përdorin forma të ndryshme të përdorimit të veglave modern në gjuhë.

Edhe përpos kësaj, në komunikimet individuale kemi një dukuri interesante të përdorimit të një shqipe me shkurtesa, shenja, simbole dhe mënyra tjera semantike, që ne do e quajmë gjuha e internetit. Shumë faktorë ndikuan në vendimmarrjen time që tezën e magjistraturës dhe lëndën e hulumtimit tim t'ia dedikoj përdorimit të gjuhës shqipe në internet. Mes tjerash ndikim të konsiderueshëm kishte edhe lënda sociolinguistikës e cila më mundësoi të jem në kontakt të drejtpërdrejt me këtë problematikë dhe në veçanti përvoja ime si studente e gjuhës shqipe (gjatë procesit të punimeve seminarike), por jo dhe faktor më pak i rëndësishëm, është mentori im, i cili ishte inspirimi im dhe përkrahësi gjatë gjithë studimit tim.

Ky hulumtim ka vlerë të madhe, para së gjithash, për vetë faktin se ajo trajton një temë mjaft aktuale, të cilës gjerë më tani në kulturën shqiptare nuk i është dhënë rëndësi të mjaftueshme dhe nuk është hulumtuar në sasi të mjaftueshme. Shkaku kryesor për këtë është përdorimi i gjuhës shqipe në internet.

Meqë sot shqiptarët, duke iu falënderuar internetit, mund të komunikojnë me njëritjetrit dhe me familjarët e tyre qofshin ata në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, apo në diasporë, përdorimi i një gjuhe të pastër, qoftë në format e komunikimit me zë e pamje përmes videokonferencave mund të ndihmojë një unifikimin e gjuhës standarde pa marrë parasysh ku jetojnë.

Interneti mund të ndihmojë edhe në ruajtjen e varieteteve të rrezikuara të shqipes, siç janë arvanitishtja dhe arbërishtja. Duke qenë mjet i komunikimit global, interneti mund të ndihmojë në afrimin dhe në vendosjen e ndërkomunikimit midis folësve të arbërishte dhe të arvanitishtes me botën tjetër shqiptare. Kjo do të mund të ndihmonte në ruajtjen nga zhdukja të këtyre varieteteve të shqipes.

Ky punim magjistrature dhe hulumtimi i tij mund të jenë pjesë e librit, i cili nuk ju përkushtohet vetëm studentëve apo intelektualëve, por edhe individëve tjerë të cilët janë para së gjithash në kontakt të drejtpërdrejt me gjuhën shqipe. Prej këtij del imperativi i tij

përfundimtar - të shërbejë si material informues me atë t’jua lehtësojë përdorimin e gjuhës shqipe dhe shmangie nga format e gabuara në internet.

Aktivitetet ndërvepruese në internet shfaqin edhe variacionin e plotë gjuhësor të shqipes. Në dhomat e bisedave (chat rooms), në format e komunikimit përmes mesazheve të çastit në mesenxherë (messenger instant messaging) dhe format e tjera të komunikimit të ndërmjetuar me kompjuter (CMC) shqipja del në të gjitha variantet e saj gjeografike, por edhe në formë të kodeve shoqërore, disa prej të cilëve mund të quhen regjistra të veçantë, siç është p.sh. komunikimi me mesenxher.

Pra, variacioni gjuhësor do të ketë një shtrirje të gjerë. Përveç kësaj, do të ndeshen edhe dukuri të tilla si ndërrimi i stilit, pra ndodh që në rastet e caktuara të ketë përshtatje të stilit dhe në raste të tilla kemi lëvizje drejt anës formale të spektrit stilistikë dhe anasjelltas, varësisht nga vëmendja që i kushtohet ligjërit të individit.

Kombinimi i rezultateve empirike dhe konstatimet nga pjesa teorike do të rezultojnë me sqarime të esencës së fenomenit - interferenca gjuhësore, si dhe mundësia e mungesës së saj.

Natyra e kësaj teze magjistrature më ka imponuar përdorimin e metodave bazë (deduksioni dhe induksioni). Përveç këtyre metodave, metoda tjera që i kam përdorur janë:

- Burimet e literaturës (*burimi primar* – Interneti, *burimi sekondar* - Biblioteka Universitare)
- *metoda hulumtuese* – hulumtimi është bërë në të gjitha ueb faqet për riprodhimin e plotë në formë të shkruar të formës së folur, në veçanti gjuha e përdorur në komunikimet elektronike si: *MSN, SMS Viber, Whats App*: ku do të hasen forma të ndryshme si: bon (bën), du (dua), mir (mirë), koma (këmba), ene (edhe), kokshna (qenkam), pra forma të cilat individ i përdor në të folurit e tij të zakonshëm, aka diçka (për a ka diçka), pom doket (po me duket), si dhe prirja për t’i shkruar format që shkruhen me apostrof pa apostrof (sdi ose zdi në vend të s’di, skam në vend të s’kam), nuk bëhet fare dallimi midis grafemave ç/q dhe kryesisht fjalët shkruhen me q (veq në vend të veç) dhe e në vend të ë dhe kjo ndodh për arsye praktike, pasi që në tastierat e zakonshme në gjuhën latine nuk ka *ç* dhe *ë* dhe këto shkronja duhet të zëvendësohen me simbole. Vërehet mospasqyrimi në shkrimin e ë-së së patheksuar dhe shkruhen *mir e un* në vend të *mirë dhe unë*, si dhe zëvendësimi i fjalës (numrit, nyjës) një-ni me numrin 1, p.sh. *spo muj 1 her, tepo7* (teposhtë) etj.
- Një riprodhim të qëndrueshëm kanë edhe pasthirrat dhe përveç emotikonëve, edhe format e shkruara që synojnë të paraqesin gjendjen emocionale të bashkëbiseduesve, si p.sh.: hahaha (të qeshur), mmmm (për të shprehur kënaqësi a shije), hhhmm

(dyshim a mendim), ufaaa (për të shprehur lodhje), pihh (për të shprehur neveri), jaak (për të shprehur gërdi) etj.

- Në anën tjetër, vlen të theksohet se kjo formë e komunikimit është e ndikuar mjaft nga anglishtja. Ndryshimi i kodit haset shpesh, sidomos kalimi nga shqipja në anglishte, ose ndonjë gjuhë tjetër (gjermanisht, italisht etj.). P.sh: ok (në rregull, mirë), np (no problem – s’ka problem), brb (be right back- kthehem menjëherë), lol (laughing out loud - qesh me të madhe), yeah (yes- po), whazz up (whats up - ç’kemi), u (you - ti), u 2 (you too - ti gjithashtu), 4 u (for you- për ty) etj.

Kreu i parë

GJUHA DHE INTERNETI

Interneti është rrjet me mundësi për kyçe publike të rrjeteve të ndërlidhura kompjuterike, që transmetojnë të dhëna standard. Me fjalë të tjera, interneti është rrjet i rrjeteve që përmbanë miliona pjesëza të vogla rrjetesh rajonale, akademike, të biznesit e qeveritare, të cilat në vete përmbajnë informata dhe shërbime të ndryshme, siç janë posta elektronike, format e kontaktit, transferuesit e skedave dhe dokumentet e tjera nga e gjithë bota.

1. Interneti

Ura lidhëse midis individëve të ndryshëm të shoqërisë kudo që ato ndodhen dhe nëçdokohë. Një burim i pafund informacioni në çdo gjuhëtë dëshiruar

Afrimi i njerëzve me njëri tjetrin një mundësi e mirë pse jo për të krijuar miq të rinj...

Gjuha është mjeti kryesor i komunikimit dhe pa gjuhën as që mund të paramendohet komunikimi. Ajo u shërben njerëzve për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre e për t'u marrë vesh me njëri-tjetrin në shoqëri (Grup autorësh, 2009:7). Mirëpo ajo nuk është e njëjtë në çdo shoqëri, por ajo ndryshon dhe secili grup shoqëror e ka gjuhën e vet për të komunikuar. Gjuha përcillet brez pas brezi dhe mbetet po ajo gjuhë, secila gjuhë ka edhe historinë e saj që është e lidhur ngushtë me historinë e popullit që e ka folur. (Hamiti – Ibrahim, 2006:2) Ajo shërben për çdo komunikim dhe materializohet në dy mënyra: me të folur dhe me të shkruar. (Hamiti – Ibrahim, 2006:2).

Sipas John Lyons “gjuha është diçka që ne zakonisht e kundrojmë si të natyrshme; diçka me të cilën ne jemi ambientuar që në fëmijëri në mënyrën praktike dhe të pandërgjegjshme”. (Lyons, 2001:20) Gjuha është më shumë se një sistem i përcjelljes së mendimeve, ajo është një veshje e padukshme që na zbukuron shpirtin dhe të gjitha shprehjeve të saj u jep formë të pacaktuar. (Sapir, 1980:249) Interneti është shumë i ri, por ka marrë përhapje të gjerë, është një koleksion i pa masë rrjetesh kompjuterike të ndërlidhura, të mëdha dhe të vogla, që shtrihen gjithandej rreth botës. (Çepani, 2006:389) Interneti tek të rinjtë na ofron shumë mundësi por edhe rreziqe. Kemi aspekte negative të sjelljes online të të rinjve, si varësia, si dhe rreziqet në internet. Përveç kësaj, kemi aspektet pozitive të përdorimit të internetit, siç është potenciali i tij për të mësuar dhe nxitur marrëdhëniet shoqërore. Rezultatet tregojnë se rreziqet online të tilla si: varësia, shoqërohen me pasoja negative për rininë. Është e rëndësishme të theksohet se për fëmijët duhet të kenë kujdes prindërit se çfarë kontaktesh kanë në internet. Interneti gjithashtu mund të ofrojë përfitime në

fushat e zhvillimit social dhe fizik. Teknologjia është bërë si ushqim për të gjithë e më shumë për të rinjtë. Interneti gjithashtu ka shumë aspekte pozitive dhe mund të përdoret për të rritur të mësuarit dhe fuqizimin e të rinjve; Interneti është bërë gjithnjë i përhapur në jetën e të rinjve. Megjithëse është një burim i jashtëzakonshëm dhe mund të themi se përdoret shumë, ne duhet të kuptojmë se si t'i zbatojmë më mirë ato për të rritur efektivitetin e tyre.

Përdorimi i tepërt i internetit po shfaqet si një nga aspektet më negative të aktiviteteve online të të rinjve. Në literaturë, përdorimi i tillë ekstrem është shpesh sinonim me termat :, 'përdorimi problematik i internetit', 'përdorimi patologjik i internetit', 'varësia nga interneti', 'varësia e kompjuterit' dhe 'varësia neto'. Varësia e internetit, termi që ne përdorim këtu, është përcaktuar si përdorimi i Internetit për të shpëtuar nga anët negative, përdorimi i vazhdueshëm i Internetit, kemi dëshmi se varësia në internet ka efekte negative si : nuk mësojnë sa duhet (rënie në nota), marrëdhëniet familjare (duke fshehur përdorimin e tyre të tepërt në Internet nga prindërit), shëndetin fizik (nuk flenë sa duhet qëndrojnë gjithë natën nëinternet). Bisedat online, e-mailet dhe lojërat në internet janë më së shpeshti të lidhura me varësinë e internetit tek të rinjtë. Për të rinjtë, interneti paraqet një numër të rreziqeve së bashku me një mori mundësish. Disa rreziqe në internet me të cilat ballafaqohen të rinjtë janë varësia, ekspozimi ndaj materialeve të papërshtatshme etj. Përkundër rreziqeve, interneti gjithashtu mund të jetë i dobishëm për të rinjtë. Ai siguron një mjet për të promovuar zhvillimin kognitiv, social dhe fizik. Megjithëse ka mundësi se Interneti mund të përdoret si një mjet për të mësuarit për të marrë informata më shumë . Në përgjithësi, mund të themi se nevojiten përpjekje specifike dhe të synuara për të luftuar rreziqet në internet në mënyrë që të rinjtë të përfitojnë nga mundësitë e shumta që ofron interneti.(Bakiu, 2017)

1.1. Përhapja dhe përdorimi i gjuhës standarde në internet

Koncepti “gjuhë standarde” është disi i turbullt, për arsye se gjuhët standarde janë interesante sepse vendosin një raport të posaçëm me shoqërinë, një raport mjaft jonormal, po të vështrohet në kontekstin e dhjetave, qindrave apo mijërave vjetëve kur është përdorur gjuha. (Hudson, 2002:43). Përhapja e gjuhës është shumë e shpejtë, sidomos në komunikimet elektronike nëpërmjet internetit ajo përhapet edhe më shpejtë. Gjuha standarde shqipe është variant më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar që përfshin gjuhën që përdoret në praktikën shkrimore dhe botuese si dhe në komunikimin zyrtar të të gjitha mjediset shqiptare nga të gjithë mediet në gjuhën shqipe në Tiranë, në Prishtinë, Tetovë, Gostivar, në të gjitha stacionet radiotelevizive (Grup autorësh, 2009:19), mjeteve të komunikimit masiv dhe duke

përfshirë edhe komunikimet elektronike. Një gjuhë për t'u standardizuar në fillim duhet bërë drejtshkrimi i një gjuhe që të arrihet deri te një gjuhë standarde. Në rrafshin e drejtshkrimit, standardizimi i gjuhës mbase është proces më i lehtë, por problemet shfaqen në rrafshin e gjuhës së folur standarde. (Munishi, maj,2008).

Gjuha shqipe është një gjuhë e vjetër, ndërsa si gjuhë standarde na del një gjuhë e re,por prapë se prapë ajo ka marrë përmasa të mëdha në internet e sidomos në komunikimet elektronike.Në internet në fillim e kemi gjuhën angleze, pastaj fillojnë të përdoren edhe gjuhët tjera si: gjermanishtja, japonishtja, frëngjishtja, spanjishtja etj, ku gjuha angleze pëson rënie të përdorimit të sajë në internet.Në vitin 1990 anglishtja ka qenë diku 80 %, në vitin 2002 Alta Vista kishte parashikuar se anglishtja përdoret më pak se 50%, ku fillojnë të përdoren gjuhët lokale.(Crystal, january, 2001).

Kështu që si shumë gjuhë të tjera edhe gjuha shqipe u fut në rrjedha të internetit ku tashmë ka një përdorim të gjerë, si në komunikime, media, publikime etj.Mediumet e ndryshme përdorin gjuhë të ndryshme, në bazë të së cilës thirrjet bëhen në mënyra të ndryshme: tekst, fotografi, zë ose qasje multimediale nëpërmjet internetit.1Gjuha e shkruar në komunikimet elektronike nuk është një gjuhë e shkruar, por është një gjuhë që shkruhet.Internet po ashtu ka bërë edhe më të lehtë jetën e njerëzve, sepse mund që më shpejt të kryejnë detyra të ndryshme me anë të internetit dhe risive teknologjike, se sa në forma tjera.Nuk duhet të harrojmë se interneti është mënyra më e mirë për afirmimin dhe për lidhjen e kulturave dhe të popujve. (Islamaj, 2009).

Por nuk do të thotë se edhe zhvillimi i teknologjive dhe veçanërisht interneti janë të përsosur dhe mund të bëjnë gjithçka.Nëse e shikojmë me vëmendje përdorimin e gjuhës në internet, duke qartë se gjuha shqipe nuk është një gjuhë që paraqitet si duhet dhe në komunikime nuk është ajo gjuhë që duhet të jetë.Vite më parë kemi filluar të shohim efektet gjuhësore të komunikimit me anë të teknologjisë më të fundit. (Crystal, 1999:19-20)Që gjuha të përmirësohet dhe të ketë një paraqitje të duhur dhe mënyrë më të mirë të komunikimit sot në botë, duhet që institucionet kulturore e shkencore në trevat shqiptare të bëjnë përmirësimin që gjuha të përdoret drejtë dhe mirë.Duhet të krijohet një bibliotekë e madhe elektronike e kulturës shqiptare në internet,shumë e nevojshme e shumë e dobishme, jo vetëm për integrimin e kulturës shqiptare në integrimet ballkanike e botërore, po edhe për shfrytëzuesit shqiptarë anë e kënd botës, në të cilën bibliotekë elektronike do të përfaqësohej në mënyrë sistematike kultura shqiptare dhe ajo të prezantohet në rrjetin global.Një punë të tillë mund ta bëjë çdo institucion shoqëror e kulturor në bashkëpunim me institucionet tjera, që të vijë deri

te përmirësimi i gjuhës në internet. Secili institucion shkencor dhe kulturor elektronik duhet të mundohet të ruajë dhe të jap kontribut për përmirësimin e gjuhës, duke mos lejuar që ajo të dëmtohet dhe nëse secili institucion elektronik të merr një përgjegjësi mbi vete që të ndihmoj në këtë aspekt, atëherë kjo do të jetë shumë pozitive në ruajtjen e gjuhës, duke i provokuar edhe institucionet tjera elektronike që të bëjnë një gjë të tillë dhe shumë më lehtë do të mund të kemi komunikime me gjuhën e duhur.

1.2. Përhapja dhe përdorimi i emotikoneve, varieteteve dialektore dhe shoqërore në internet

Gjuha ka një funksion shoqëror, qoftë si mjet komunikimi, qoftë si mënyrë për identifikimin e grupeve shoqërore dhe mund ta studiosh atë, pa iu referuar shoqërisë që e përdor. (Hudson, 2002:15) Gjuha si mjet komunikimi përdoret në të gjitha fushat e jetës, mirëpo ajo gjatë përdorimit pëson edhe ndryshime, ndryshimet ndodhin nga përdoruesit e gjuhës, varësisht kush e përdor atë, ashtu vijnë edhe pasojat e ndryshimeve. Secili popull ka edhe gjuhën e vet, e cila pastaj ndahet në dialekte, dialektet në nëndialekte dhe mund të themi se secili grup shoqëror ka mënyrën e vet të përdorimit të gjuhës. Ndryshimet shoqërore, dyndjet e emigrantëve nga territoret shqipfolëse dhe dallgët e risive teknike janë pasqyruar në gjuhë dhe mënyra më realiste për të regjistruar këtë është ajo digjitale. Në vend të parë këtu mund të përmendet kërkesa për depolitizimin e shpjegimeve, përfshirja e huazimeve të afirmuar. (Bejleri, shkurt 2006) Nga vetë fakti se gjuha pëson ndryshime kohë pas kohe, nuk mund të themi se ajo vijnë nga një shoqëri e caktuar, por shoqëri të ndryshme sjellin ndryshime të ndryshme dhe mund të bëjmë edhe një ndarje, intelektualët përdorin gjuhën standarde, njerëzit e thjeshtë dialektin që i përkasin, gjuha e të rinjve dallon nga gjuha e më të moshuarve e të tjera. Faktorët kryesor për ruajtjen e gjuhës janë fëmijët. Fëmijët duhet të mësojnë mirë gjuhën e tyre. Ata duhet të mësojnë të lexojnë dhe shkruajnë, se si ta përdorin gjuhën e përshtatshme dhe se si t'u përgjigjen njerëzve të tjerë me një gjuhë të drejtë. Ata duhet të mësojnë rreth rëndësisë së gjuhës standarde. E gjithë kjo është në duart e mësimdhënësit dhe mësimnxënies dhe kjo është edhe obligimi i mësuesit, i cili duhet ta marrë mbi vete përgjegjësinë për të ndihmuar fëmijët në trajtimin dhe shfrytëzimin e potencialit gjuhësor të internetit. (Crystal, 2005:2). Gjuha standarde shqipe dhe dialektet e saj janë varietete të gjuhës shqipe që ndryshojnë ndërmjet tyre së paku në dy rrafshë: në rrafshin gjeografik dhe në rrafshin funksional. (Grup autorësh, 2009:21) Sa përket përdorimit të gjuhës në internet më tepër kemi përdorim të fjalëve të shkurtuara, shenjave, simboleve etj, duke iu larguar gjuhës standarde. Shkrimi në internet theu disa prej rregullave të gjuhës standarde në

fusha të ndryshme duke ardhur deri te ndryshimi i drejtshkrimit. E gjithë kjo ka ndodhur, në fakt, se gjuha është një burim për shprehjen e informatave dhe gabimet në shkrim janë rritur jashtëzakonisht.(Crystal, 2005:2).

Kjo vjen si rezultat i zhvillimit të teknologjive, përhapja e internetit dhe komunikimet elektronike të shpeshta, ndonjëherë ndikojnë negativisht dhe e dëmtojnë gjuhën.Kjo teknologji ka ndikuar edhe për ndërtimin e një modaliteti tjetër gjuhësorrealizimin e të folurit përmes shkrimit, (Paçarizi, 2006:173) komunikimi është më i shpejtë dhe pa pengesa.Natyrisht, me anë të internetit, mundësohet përdorimi i kontekste të ndryshme si: Email,grupet chat, faqet e lojës, përdorimi i telefonave celular dhe shumëçka tjetër. (Crystal,1999:19-20).Por gjuha mbrohet që të mos e mbushë inventarin e saj me shaka të lira (Spinnen-Verbica, 2012), sepse ato edhe më shumë e dëmtojnë.Duke e njohur ekzistencën e varieteteve të ndryshme të shqipes dhe variacioni sociolinguistik që ekziston brenda saj, duhet gjithashtu të jemi të vetëdijshëm edhe për raportet që ekzistojnë midis këtyre varieteteve. Raportet midis gjuhës standarde dhe varieteteve dialektore ndër ne shpesh herë janë parë dhe konceptuar, sipas mendimit tonë, në mënyrë jo të drejtë. Kur fliste për raportet midis gjuhës standarde dhe dialekteve, Androkli Kostallari theksonte, se “raportet ndërmjet gjuhës letrare kombëtare dhe dialekteve,nëndialekteve e të folmeve, nuk janë raporte të barasvlershme, por janë, në thelb, raporte ndërmjet një makrosistemi *sui generis* dhe disa mikrosistemeve që ndryshojnë prej njëritjetrit,nga tiparet, vlerat e funksionet. (Munishi, maj 2008)Sipas Hudson, po të mendosh për gjuhën si një dukuri që përfshin të gjitha gjuhët e botës, termi **VARIETET GJUHËSOR** ose më thjeshtë **VARIETET** mund të përdoret për t’ju referuar shfaqjeve të saj të ndryshme. (Hudson, 2002:32)Me anë të internetit janë ndryshuar ndjenjat tona të përgjegjësisë së përdorimit të gjuhës së drejtë, duke i detyruar njerëzit të mendonin rolin e tyre si komunikues. Nëse varietetet në gjuhësi janë në zhvillim, atëherë marrëdhënia në mes të gjuhës standarde dhe jostandarde është shumë e mundshme dhe kjo ka pasoja të menjëhershme edukative. (Crystal, 2005:2)

Kreu i dytë

FJALËT DHE SHENJAT

MË TË PËRDORURA

NË KOMUNIKIMET

ELEKTRONIKE

1. Fjalët dhe emotikonet më të përdorura në komunikimet elektronike

Në epokën teknologjike në të cilën jetojmë, gjithmonë e më shumë po debatohet në lidhje me rrallimin e të shkruarit me dorë, ndërkohë që lapsa e stilolapsa, ashtu si edhe letra, shpejt po shndërrohen në relike thuajse të lashta, me përparimin e mëtejshëm të teknologjisë. Një pjesë e theksuar e panoramës filozofike të shekullit të XIX, gjithaq edhe mendja pjellore e dikujt aq kokëfortë dhe polemik si Shopenhaueri, vinte në dukje praninë e dy llojeve të shkrimtarëve. Ky kategorizim i thjeshtë dhe i përmbledhur theksonte qartësisht dallimin midis atyre që shkruanin për hir të tematikës përkatëse në vetvete, domethënë, që kishin patur ide dhe përvoja që i patën cilësuar si të vlefshme për t'u komunikuar gjerësisht, dhe atyre që shkruanin thjesht për të shkruar duke e mbështetur në nevojën e përfitimit financiar tërë prirjen e tyre. Në këtë kontekst mund të përfshihen edhe letrat e shkruara për shekuj me radhë me dorë, letra të çdo lloji, njoftime, letra dashurie, urime, etj. Me shumë mundësi gjithkush pati shkruar me dorë letra, kartolina, pusulla me dorë, i përkiste grupit të parë syresh, të atyre njerëzve që dorëshkrimin e cilësonin si mënyrën më efikase dhe të drejtpërdrejtë për të dëshmuar me tërë dashamirësinë e rastit se i merrte malli për dikë, se ndienin dashuri për tjetërkënd, se u mungonte dikush. Nevoja në fjalë për të kapur një laps, një stilolaps, një penë, për të shkruar në letër gjithçka dëshironin të mbetej ashtu e ngrirë në kohë, tashmë është shndërruar në diçka që ngadalë po nis të duket si krejt e harruar, veçanërisht kur shohim si letrat nuk përdoren më si mjet komunikimi, njëlloj edhe posta nuk kryen më këtë funksion, gjithashtu edhe kartolinat përshëndetëse për festa nuk përdoren më.

Gjithçka që për shumë kohë ishte përdorur si hapësirë e nevojshme për këtë qëllim, si njëfarë terapie e menjëhershme e të shprehurit, ndjesi dhe epoka që me kalimin e kohës janë duke u zëvendësuar me emotikonet e tre majmunëve që mbyllin veshët, gojën dhe sytë, “sticker” të gjithanshëm. Ndërkohë që ndodh ky ndryshim paradigmash, në evoluim e sipër të mjeteve të komunikimit, teksa presim edhe zhdukjen e mundshme të vetë ushtrimit të të shkruarit me dorë, mes uraganit teknologjik që mbizotëron në realitetin tonë të tashëm, gjithsesi një pyetje bëhet e pashmangshme: a jemi vallë duke harruar të shkruajmë me dorë apo thjesht jemi duke mësuar të komunikojmë në një mënyrë të ndryshme?

Siç pohon filozofi dhe përkthyesi spanjoll Fernando Castro: “Mund të luajmë me idenë post-Derrida (filozof i njohur francez), që thotë se nëse historia e filozofisë ishte, ndër të tjera, harresa e të shkruarit, rrjedhimisht, një orientim dëgjimor e zanor, ndërkohë epoka e

tashme globale, nën shenjën e neoliberalizmit shenjohej nga rrëgjimi i të shkruarit. Nuk besoj se jemi përfshirë fort nga ndonjë amnezi lidhur me të shkruarit apo që përballemi me mospërdorimin tërësor të shkrimit me dorë, përkundrazi, kemi të bëjmë me një prani tejet të shtuar të tij, një lloj deficioni qëmtues për shkak të hiperaktivitetit. Neve shkruajmë me tepri, rrimë tërë kohën duke postuar çfarë shkruajmë dhe nuk arrijmë dot të përmbahemi. Jemi shndërruar në delirantë të çartur të të shkruarit të pandalshëm”. Në rastet kur nuk përzgjedhim veç një mënyrë të veçantë të të shkruarit (me dorë apo jo), atëherë vështirësisht mund të biem pre e këndvështrimeve katastrofiste, sikur të nevojitej akoma të shkruanim veç me pendë shpendësh si qëmoti. Xhungla e tabletëve, telefonave të mençur, laptopëve, kuptueshëm e koklavit të shkruarit, sidomos kur shkruajmë me dorë, pa mundur sidoqoftë ta pamundësojë këtë gjë. Faktikisht shpesh na ndodh që të lexojmë dhe shkruajmë në të njëjtin aparat teknologjik dhe meqënëse këto dy veprime kryhen në të njëjtin vend, jemi të detyruar që të shkruarit t’ia përshtasim të lexuarit. Përdorimi i Viber, Whatsapp, Messenger, vlen si shembulli më i qartë në këtë kontekst, sepse chat-i mund të nënkuptohet si diçka më vete. Kjo lloj dikotomie midis gjuhës së shkruar, që përgjithësisht është më shumë e menduar, formale dhe rreptësisht më e shkëputur, dhe gjuhës gojore, që përafrohet me afrinë dhe çiltërsinë, ka gjetur një hapësirë që gëzon tipare të sakta.

Një hapësirë me mjetet e saj përkatëse dhe kodet përkatës të komunikimit, përdorimi i të cilës në momentin e shprehjes së një mendimi varet kryekëput nga vullneti individual i përdoruesit të radhës. Shumëkush mund t’ia ketë nisur duke shkruar me dorë me laps, pastaj me makinë shkrimi si dikur, gjer në kohën e kompjuterëve të parë. Ndokush ka diktuar artikuj gazete nga telefoni fiks, tjetërkush ka dërguar tekste të tërë përmes një aparati të moçëm të zbërdhulur të quajtur faks, kurse tanimë gjithçka kryhet urtë e butë në internet. E vuajmë vallë mungesën e të shkruarit me dorë? Ndoshta vërtet na mungon të shkruarit me dorë, por t’i mohojmë mundësitë e pakufishme që na ofron bota e teknologjisë në lidhje me komunikimin mes njerëzve, do të ishte jo vetëm e gabuar, por diçka e rrezikshme. Fjalët vijnë të kërkojnë që dikush t’i shkruajë, me qëllim që, siç thoshte një i mençur njëherë e një kohë, mos t’i marrë era, por sakaq përzgjedhja e mjeteve përkatëse për ta bërë këtë gjë, qoftë një tastierë kompjuteri apo laptopi, një tastierë elektronike tableti apo telefoni të mençur, një stilolaps, me gishtat e dorës apo të këmbës po të jetë nevoja, kjo gjë ka për t’u varur veç nga interesi që do të shfaqin brezat e ardhshëm për të mos e shndërruar artin e mahnitshëm të të shkruarit në një kujtim të largët. (Sidheri, 2019).

2. Gjuha e porosive nëpërmjet postës elektronike

Gjuha si mjet komunikimi gjendet gjithkund në forma dhe mënyra të ndryshme qofshin ato standarde apo dialektore. Gjuha standarde shqipe i përket gjithë truallit ku shtrihet populli shqiptar, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, kurse dialektet i përkasin një mjedisi të kufizuar territorial. (Grup autorësh, 2009:21) Gjuha dialektore përdoret më tepër gati se në çdo vend, përdorimi i dialektit mbisundon edhe në komunikimet elektronike ku më tepër përdoret gjuha dialektore, se sa ajo standarde. Sa i përket komunikimeve elektronike të mesazheve elektronike nëpërmjet postës elektronike kemi mjaftë ndryshime në gjuhë dhe nuk përjashtohet rasti edhe të shkurtimeve ifjalëve. Gjuha në mesazhet elektronike nëpërmjet postës elektronike është një gjuhë e njëjtë por me më shumë ndryshime, duke filluar nga ndryshimet dialektore, shoqërore dhe gati se çdo shoqëri ka një gjuhë të veten për komunikim, duke përfshirë edhe moshën, se në vende të njëjta, mosha të ndryshme përdorin gjuhë të ndryshme. Përdorimi i gjuhës nëpër posta elektronike pëson shumë ndryshime, ku nga ana e të rinjve përdoren edhe shumë ndërkombëtarizma dhe huazime nga shumë gjuhë të tjera. Në vazhdim do të shohim se si përdoren shumica e fjalëve nëpër posta elektronike nga të rinjtë e Prishtinës, Tiranës dhe shqiptarëve të Maqedonisë. Fjalët më të përdorura që i kam hasur nëpër posta elektronike u takojnë moshave të ndryshme dhe ato janë: **Atë** (ata), **ashtë** (është), **bashkengjitur** (bashkangjitur), **mbrenda** (brenda), **bona** (bëra), **doni** (ndonji), **emajli** (e-mail, postë elektronike), **falemnderit** (faleminderit), **gjat**(gjatë), **ish** (isha), **info** (informatë – njoftim), **ina** (jemi), **jan** (janë), **jua** (ua), **mireupafshim**(mirupafshim), **nëqoftse** (në qoftë se), **ni** (nji), **nxhit** (ngjit), **produkt** (produkt), **rendajta** (rendita), **sillni** (sjellni), **sivi** (cv (cirrikulum vitae) – biografi)², **si ia kalove** (si kalove), **shum– shaum** (shumë), **shtaj** (tash), **shajf** (shih), **tej** (ty), **zyret** (zyrat) etj. Sa i përket postës elektronike nuk kam hasur shumë fjalë që nuk i takojnë gjuhës standarde, shumë fjalë janë të gjuhës standarde dhe shumë pak janë të tjera, për arsye se posta elektronike shfrytëzohet më tepër për punë më serioze dhe më pak për biseda të lira, në dallim nga komunikimet tjera elektronike që më tepër shfrytëzohen për biseda të lira. Edhe në postë elektronike ekzistojnë varietete dialektore, por jo aq shumë sa të rrjetet tjera sociale, në postat elektronike kemi numër të vogël të fjalëve që nuk i takojnë gjuhës standarde.

Disa shembuj të marrë nga posta elektronike:

1. Mire flm tej si te kam...oj jo asni informat amen nuk besoj se do vijecat ene ne ina cudit.

2. *Oj shajfa eshte mire, en nese e ke at dokumentin ne pdf coma, en kto comi krejt komplet, tenden, pastaj un e planifikoj ni perfundim.*
3. *Se pari ju falenderoj shume per qendrimin tuaj si dhe per e-mailin tuaj.Per sa i perket faturimit kjo gje behet per arsye qe klientet ne rast se kane ndonjendryshim te planit mos jene te detyruar t'i paguajne sherbimet extra. Une jufalenderoj edhe nje here qe na keni zgjedhur neve.*
4. *Te bashkengjitur po ua dergoj kerkesen.*
5. *Se pari shpresojme te jeni mire.Ne vijim Ju dergoj mailJu kontaktoj ndoshta jeni shum i angazhuar me pune nuk deshem tju pengojmeme shume.Ju deshiroj nje dite te kendshme.Pershendetje.*
6. *Ju faleminderit shumë për interesimin nga ana juaj për bashkëpunime të mëtejshme. Ju mirëpresim për vizitë në zyret tona në mënyrë të që thellojmë edhe më shumë bashkëpunimin.*
7. *Ne kemi faturu vetem nje product dhe te tjerat jemi duke i faturu.*
8. *Pershendetje te nderuara,Uroj te keni kaluar fundjave te mire!Te bashkangjitur jua dergoj detyren.Ju lus qe deri te enjten te perfundoni. Mirupafshim deri te ejten.,*
9. *E rendajta pak punimin te pjesa jem.se ishin nxhit shoum fjalit me tabelat..ja ajoperfundimtarja. En nja 4 tabela, en e shtaj ne list!!!*

Nga kjo që shohim më sipër vërejmë se gjuha e shkruar është një gjuhë që i takongjuhës standarde, me ndonjë gabim drejtshkrimor dhe me ndonjë fjalë dialektore, porprapëseprapë mbizotëron gjuha standarde dhe gjuha e pastër shqipe. Por prapëseprapë sa i përket gjuhës në postë elektronike nuk kemi shumë problem, nëkrahësim me gjuhën që përdoret në komunikimet tjera elektronike. Gjuha që përdoret në komunikimet tjera elektronike është një gjuhë me shumë gabime dhe një gjuhë që ndryshon nga gjuha e folur, sepse gjuha e folur është më e pastër se gjuha e shkruar. Më tepër mesenxheri në facebook përdoret nga të rinjtë kryesisht nxënësit, studentët , nga intelektualët por përdoret edhe nga njerëzit e thjeshtë.

3. Gjuha e mesazheve elektronike në sms

Zhvillimi i teknologjisë dhe risitë teknologjike e kanë bërë edhe jetën më të lehtë, duke filluar nga çdo aspekt. Informimi është më i shpejtë edhe nëpërmjet mesazheve kemi një informim të shpejtë dhe mesazhet përdoren me një numër shumë të madh në çdo ditë. Përdorimi i mesazheve në fillim ka qenë shumë i madh dhe sipas disa të dhënave gjatë viteve 1990 telefonat celular më tepër janë përdorur për sms dhe kanë vazhduar të përdoren deri në vitin 2000, ku në gusht të vitit 2000 janë dërguar përafërsisht 8000000000 mesazhe, dhe 81 për qind e përdoruesve të telefonave celular janë të moshave 15 deri 24 vjeçare që është hulumtuar në shtator të të njëjtit vit. (Crystal, 1999:19-20) Ku me të madhe përdorin telefonat celularë për tekste të mesazheve.

Gjuha në internet përdoren shumë ndryshe nga gjuha standarde, pra forma të cilat individ i përdor në të folurit e tij të zakonshëm dhe do të përmendi disa fjalë që janë hasur në tekste mesazhesh: **Aha** (aha), **aplikaum** (aplikuam), **amën** (aman), **apën** (japin), **bojsha** (bëjsha), , **boj** (bëjë), **bon** (ban), **bima** (bjerma), **ç'tej** (tash), **çish bon** (çka ban), **dën** (don), **dokush** (dikush), **dokund** (dikund), **diftom** (tregom), **dojsha** (desha), **oshtë** (është), **gzohem** (gëzohem), **gjali** (djali), **ini** (jeni), **jom** (jam), **kini** (keni), **kën** (qenë), **kauma** (këmba), **kallzom** (tregom), **kurxho** (asgjë), **kejt** (krejt), **këm – kom - kum** (kam), **kërkau** (kërku), **meir - majr** (mirë), **mujm** (mund), **mbretëm - mbrëjtëm** (mbritëm), **mbar** (mbarë), **mrëjti** (mbrini), **mrapa** (pastaj), **najsish** (nisish), **nisi** (filloi), **nosje - nausja** (nusja), **nejs – najs** (nis), **nauk** (nuk - jo), **skom** (s'kam), **shpi** (shtëpi), **shotajsëm** (shëtitim), **smrehet** (nuk mbrihet), **sojve** (syve), **si je** (qysh je), **ska xho** (s'ka gjë), **saunde** (sonte), **shkoj** (shkoi), **shotajs** (shëtis), **shtahej - shtej** (tash), **shaum - shoom** (shumë), **shofim** (shohim), **shkrauj** (shkruaj), **tpajs** (të pyes), **tej** (ty), **tkçija** (të këqija), **thon** (thuan), **tahej** (tash), **tique** (tutje), **pergaditu** (përgatitu), **xhamëjs** (xhamis), **vikas** (bërtit), **zonat - zënat** (zërat) etj. Gjatë hulumtimit kam vërejtur se shumica e fjalëve që pësojnë ndryshime janë folje dhe një pjesë e vogël janë emra dhe pjesë të tjera të ligjëratës.

Më poshtë do të theksojë disa mesazhe (message):

Sms 1: Tung si tkam? Me fal se tpengoj dojsha tet pejs a do shkojsh sot? De shkojsh ne pun? Un hiç se di xhit boj.

Sms 2: Pershendetje, cka po ban, a je mir? si po kalon? Shpresoj qe te gjith jeni mir, shum tfala.

Sms 3: Oj couc po sa mrojta ke dera jot e pash sms.

Sms 4: Ok shqir ci mrëjki majr klm tfala.

Sms 5: Mirdita a ije mer? Me shëndet si tkom?a kini vaket pak tovu shofim n msn?selam kitve

Sms 6: Hahaha përqafë shum e po kom kamere. Mujm me bisedu ne msn ose skype. Tung.

Sms 7: Mirmbrema a je mejr, dajxha, dajca a jen majr? Selam kitve, naten e mejr.

Sms 8: Po lock ama kjo e jona smrhet se di a ka si kjo,flm tej shum te fala.

Sms 9: Far ben si je far ka 3 une jam majr, naser ni cauc ka provim a mund ti ndejfish ti kalzojsh.

Sms 10: Hej a je mirë më fal për vonesën se nuk kisha kredi, ska kush tum bere. Tung natën.

Sms 11: Majr ije , pse serdhe sot , nuk shkonte sahati pa taj.

Sms 12: Si ije? A de vajsh saunde t dalim nkafe.

4. Gjuha e mesazheve elektronike të telefonisë celulare

Disa vjet më parë telefonat e lëvizshëm ose celularët, vështirë se mund të konsideroheshin si aparate vërtet të «lëvizshme». Këta telefona ishin të tillë vetëm nëse ju ishit shumë të fortë ose nëse i kishit të instaluar në makinën tuaj, meqë bateritë e tyre ishin jashtëzakonisht të rënda. Telefonat ishin më të mëdhenj sesa kutitë e këpucëve dhe kushtonin mijëra dollarë. Sot ka rreth 1,35 miliardë telefona celularë. Në disa vende, më shumë se gjysma e popullsisë ka një të tillë. Shumica prej tyre janë aq të vegjël sa fshihen në pëllëmbën e dorës dhe madje disa herë mund të marrësh një telefon edhe pa lekë.* Revista australiane *The Bulletin* raporton: «Afërsisht numri i këtyre pajisjeve që janë në përdorim është sa numri i televizorëve dhe i kompjuterëve personalë të marrë së bashku.» Në më shumë se 20 vende, tani ka më shumë celularë sesa telefona fiks. Një specialist në industri, nuk i përshkruan celularët vetëm si një mrekulli të teknologjisë, por edhe si «një dukuri shoqërore». Shumica e informacioneve që shkëmbehen nga këto pajisje të teknologjisë së lartë, nuk janë në formë bisede, por me shkrim.

Në vend që të flasin me telefon, një numër gjithnjë e në rritje përdoruesish të celularëve, veçanërisht të rinjtë po përdorin një shërbim të quajtur Shërbimi i Mesazheve të Shkurtra (SMS). Ky shërbim u lejon atyre të shkruajnë dhe t'i dërgojnë mesazhe të shkurtra njëri-tjetrit, pa harxhuar shumë. Por, duke qenë se tastiera e telefonit mbi të cilin shkruhet mesazhi është e vogël, atëherë ata që janë të dhënë pas SMS-ve, përdorin një formë të shkurtuar të gjuhës që kombinon shkronjat dhe numrat për të formuar tingullin e fjalës. Edhe

pse të shkruarit e mesazheve është i bezdisshëm po të krahasohet me të folurit në telefon, përsëri, çdo muaj, rreth 30 miliardë mesazhe shkëmbehen në të gjithë botën. Çfarë përmbajnë gjithë këto mesazhe? Një studim britanik zbuloi se 42 për qind e të rinjve të moshës nga 18 deri 24-vjeçare, përdorin SMS-të për të flirtuar; 20 për qind e përdorin këtë formë komunikimi që është në modë, për t'i kërkuar dikujt takim që të dalin së bashku, dhe 13 për qind i kanë përdorur SMS-të për t'i dhënë fund lidhjes me dikë.

Disa komentues për çështjet shoqërore shqetësohen, pasi shqiptimi i copëzuar dhe sintaksa e përdorur në SMS-të, po dëmton aftësitë e të shkruarit dhe të të lexuarit te të rinjtë. Disa të tjerë nuk janë dakord, duke pohuar se fenomeni i SMS-ve «po shkakton te brezi i ri një rilindje të dëshirës për të shkruar». Zëdhënësja e një shtëpie botuese që boton një fjalor australian, tha për gazetën *Sun-Herald*: «Rrallë kemi mundësinë të zhvillojmë një stil tërësisht të ri [të gjuhës], . . . kombinimi i mesazheve të shkruara [SMS] dhe i Internetit do të thotë se të rinjtë po shkruajnë më shumë. [Ata] duhet të jenë të rrjedhshëm dhe të kenë një shqiptim të mirë që ta kapin këtë stil të ri gjuhe dhe të bëhen mjeshtra në përdorimin e shprehjeve më të përhapura dhe të simboleve të këtij shkrimi. (Celulari: Mik apo armik?: Zgjohuni!, 18, 19: 2005)

Kreu i tretë

PËRDORIMI I
AKRONIMEVE
NË KOMUNIKIMET
ELEKTRONIKE

1. Përdorimi i shkurtesave në komunikimet elektronike

Gjuha shqipe përdoret në të gjitha aktivitetet në internet, duke përfshirë ueb-faqet, komunikimin e ndërmjetuar me kompjuter në dhoma të bisedave (chat rooms), komunikimin përmes mesazheve të çastit (Munishi, 2009), programe të reja që çdo ditë projektohen dhe futen në jetën e njerëzve si: *Msn, Skype, Facebook, Viber, WhatsApp* dhe të tjerë. Në veçanti do të flasim për këto programe: SMS- shërbimi i mesazheve të shkruara, MSN – messenger, WhatsApp dhe Viber.

Shërbimi i mesazheve të shkruara (SMS) – janë mesazhe të shkruara, që përmbajnë një tekst të shkurtër ku gjithsej përfshihen 160 karaktere (shkronja, shenja të pikësimit, hapësira etj.). **Msn – Messengers** është program i cili përdoret për komunikim ndërmjet njerëzve, me anë të folurit, të shkruarit, fotografive, kamerës etj. Ky program instalohet nëpër kompjuterë dhe kompjuterë personal, për ta shfrytëzuar këtë program duhet të ketë rrjet të internetit. **WhatsApp** është program që përdoret në telefona me anë të internetit, për tu përdorur këto programe, përveç instalimit që duhet të bëhet në aparatën e telefonit duhet të ketë edhe kyçje në internet (Wi-Fi). Ky program mund të instalohet në telefona mobil të markave iPhone, Htc, Android, Blackberry, Samsung etj. **Viber** është një program i ngjashëm me WhatsApp, vetëm dallimi i tyre është se në viber përveç komunikimit me shkrim dhe fotografive mund edhe të bësh thirrje.

Profesor Mustafa Ibrahim, në librin e tij Sociolinguistika, UNT, Shkup 2018, sjell të dhëna të shumta për disa lloje të shkurtimeve, si p.sh.

Akronimet: GZ= *shkurt.* Gëzohem; H *shkurt.* Ora; IKM *shkurt.* Ia kalofsh mirë; KLB = *shkurt.* Kalofsh bukur; PM= *shkurt.* Për të mirë; MM = *shkurt.* Mirëmëngjesi; MB = *shkurt.* Mirë mbetsh; PSH = *shkurt.* Përsëritje; DK = *shkurt.* Detyrë klase; TDSH (të dua shumë), TDF kuptimi origjinal: të dua fort, të dashuroj fuqishëm. Më poshtë po japim edhe disa shembuj tjerë: FLM, FLMSH, SPS, SKGJ, KLM, KLB, GZ, VPP, PRSH, NQS, MGJTH, DMD, DIÇ, MAJTH, MM, MSG, NIS, PS, PSP, GJTHS, GJTHSH, IKM, RRS, SH, SHM, SPS, TD, TDI, TDSH, TKXH, TPF, TUNG, ATSH, BBS, BMW, ÇDV, D&G, DK, DSH, DJ, DPD, DTTH, FBI, H, KLT, PM, MM, MB, MSN, OK, OT, PSH, SP, SKP, RN, RPS, RS, RRS, DNS, TDI, TNT, UÇP. (Ibrahim 2018:206)

Inicialet - Shumë fjalë zhargonike krijohen edhe me anë të inicialeve. Ajo që këto zhargonizma i bën humoristike është se këto shkurtesa ekzistojnë, por se këtu janë të komentuar në një mënyrë tjetër. P.sh: **FLM** (shkurtesë për **Faleminderit**)-FLi me **Mua**;

KLM (shkurtesë për **Kalofsh mirë**) - **Ke Lujt Mendsh**; **TDSH** (shkurtesë për **Të dua shumë**) - **Të Daltë Shpirti**; **SPS** (shkurtesë për **S'ka për se**)- **S'jam Për Seks**; **DSH** (shkurtesë për **Dua shumë**). - 1. **Detyrë Shtëpie**; 2. **Do e Shoh** (Ibrahimi 2018:206)

Duke u bazuar në hulumtim kemi një numër të madh të fjalëve që përdoren vetëm me disa shkronja dhe jo fjala në tërësi, por duke u kuptuar qartë dhe duke komunikuar pa probleme. Kemi shumë lloj shkurtimelesh me të cilat merremi vesh me miqtë nëpër rrjetet sociale. Disa janë më poshtë : Prsh (përshëndetje, Flm(Faleminderit), Klm (Kalofsh mirë) , Klb (Kalofsh bukur) ,Sps (ska përse) , Tkshxh (Të kam shumë xhan), T plq (Të pëlqen) , Sh bkr (Shumë bukur) ,Fls (Flasim) .Dtl(ditëlindje) , Mhb (muhabet), Nsr(Nesër), Nrm(Normal), Vër8 (Vërtetë), Mbf-të mbet në fyt ncnncn –është një lloj mohimi që shprehet pakënaqësi.

Prof. Ibrahimi në librin e tij paraqet edhe një lloj tjetër shkurtimi, që janë të përhapura edhe në gjuhë tjerë dhe këto shkurtime luajnë një rol të madh në krijimin e zhargoneve, sidomos te nxënësit dhe studentët. Në anglisht kemi *lab* për *laborator*, *gym* për *gjimnastikë*, *maths* për *matematikë*. Në frëngjisht: *pneu* për *pneumatique*, *velo* për *velocipede*, *le metro* për “*chemin de fer metropolitain*”, *perme* për *permission* (“leje” në gjuhën ushtarake) etj. Shumë prej këtyre nga zhargoni kanë hyrë në gjuhët letrare, p.sh. *kilo* (në tërë Evropën), *piano* për *pianoforte* (ose fortepiano), *auto* (frëngjisht dhe gjermanisht) etj.. Në Skandinavi kemi edhe *bil* për *automobil*, anglisht *cab* për *cabriolet*, *bus* për *autobus*, *foto* për *fotografi*. (Ibrahimi 2018:205)

Megjithatë raste cungimi ka edhe me fjalë të zakonshme shqipe: *nar* për *katundar*, *otpër otoman* (E Durham për vitin 1909); Nxënësit e shkollës ushtarake “Skënderbej” quheshin *begsa*. Shembuj të tjerë janë: *usho* për ushtar, *kusho* për kushëri, *gabi* (në togun Te Firma Gabi) për *gabelin* (Lloshi 2001: 175).

Me rëndësi është të theksohet se mundësia dhe dëshira më e madhe për shkurtime është në shoqëritë e industrializuara të kohës sonë me jetën e shpejtë urbane, sesa të themi siç është edhe sot e kësaj dite në orient, ku koha nuk ka rëndësi të tillë, ku për ta nuk ka ndonjë rëndësi shprehja “koha është para”. Shumë prej fjalëve zhargonike formohen me anë të shkurtimit të fjalës themelore. Këta zhargone janë shumë të pranishëm në bisedat e përditshme, dhe nuk paraqesin ndonjë problem komunikimi, dhe plotësisht kuptohen. Disa nga zhargone të tillë janë: *faks*– *fakulteti*; *profi* – profesor; *bus* – autobus; *koka* – kokaina; *kok* = *shkurt. nark. Kokainë*; *kokos* =*nark. Kokaina*; *edra* = *shkurt. Kuçedra*, për dashnorët e tmerrshme, ose gratë që të hanin çaçkën e syrit; *paçim*= *shkurt. Mirupafshim*; *pau* = *shkurt. Mirupafshim*; *baj* = Nga anglishtja *bye* për:mirupafshim; *OT* *shkurt. Për otoman* (E Durham për vitin 1909); (Lloshi 2001: 175).

Nga analizimi i shembujve, zhargonet mund të kenë rënie të ndryshme fonetike, ata mund të kenë;

Rënie në **fillim të fjalës** (apokopa): *shatar* për fshatar, *net* për internet, *tjeta* për tungjatjeta. Ja edhe disa shembuj: *begsa, bil, bus, dam, edra, elle* (<*baxhelle*), *fon, lici. llusto, nar, nare, nari, net, paçim, shata*.

Rënie apo shkurtim në **mes të fjalës** (sinkopa) : *katnar, katnort* e Tiron, *bugar, rike*

Rënie në **fund të fjalës** (afereza): *kusho* për kushëri (Lloshi 2001: 175); *tung* për tungjatjeta, si dhe shumë shembuj tjerë: *auto, bal, barca, basket, cel, ciga, cigo, diç, foto, gabi, gym, juve, kam, kilo, kok, kusho, lab, maths, mob, natën, ot, paçim, piano, profka, psiko, push. tel, tun, usho, velo*.

Më poshtë do të japim disa shembuj me këto shkurtesa të shënuara më lartë: Prsh si jeni? ,Mir flm!, Sa bkr dukesh!, Mos i bon mhb atij!, Festo sot është dtl jote!, Shkr me prof po se ka kthy ende! ,Nencn n nuk e kthen ai duhet ti shkrujsh ma shpesh! (Bakui, Gjuha e të rinjve në rrjetet sociale, 2019)

2. Fjalët e shkurtuara në *Whats App*

Ne jemi në fillim të një epoke të aplikacioneve të bazuara gjuhësisht online – një epokë e cila do të shohim lindjen e një gjuhe që aplikohet në internetit. (Crystal, 2005:3) Në aplikacionet online hynë shumë programe, ku do të flasim për **WhatsApp** dhe **Viber**. WhatsApp është një program i cili instalohet në telefon celular dhe shërben për komunikim me anë të shkruarit dhe në ditët e sodit është i përhapur shumë gati se çdokënd. Është pa pagesë, vetëm për të funksionuar ky program është e nevojshme të ketë rrjetë interneti apo Wi-fi. WhatsApp është përhapur gati se në të gjithë botën dhe përdoret vazhdimisht, por përdorimi i tij ka bërë edhe shumë ndryshime në gjuhë, si në të gjithë gjuhët e botës ashtu edhe në gjuhën shqipe ka mjaftë ndryshime të gjuhës. Gjuha shqipe është një gjuhë që përdoret në vende të ndryshme dhe në forma të ndryshme, ashtu përdoret edhe në internet, varet se nga kush përdoret dhe pëson ndryshime. Më poshtë do të theksoj disa fjalë që janë hasur në internet në komunikime elektronike të WhatsApp nga shqiptarë që jetojnë në vende të ndryshme: **Ahë** (aha), **amën** (aman), **axhë nau** (agjëru), **asnjenën** (anjanën), **ardhen** (ardhë), **ashatu** (ashtau), **ataj** (aty), **bojsha** (bëjsha), **bon** (bënë), **bji** (blej), **çashtau** (ashtu), **çëntë -qantë** (çantë), **çekët** (këtë), **çello** (shiko), **dokundi** (dikund), **dritohena** (drejtohena), **dush** (duash), **dënise** (ndonjë send), **është - osht** (është), **gejle** (gajle), **gzaojsh** (gëzojsh), **ijet**

– **jetë** (të jetë), **inten** (ejten), **kisha** (pata), **kshtau** (kështu), **këm** (kam), **kta** (këta), **knaçi** (kënaqi), **kit** (krejt), **lishohem** (lëshohem), **mejr** (mirë), **motin** (vitin), **mcon** (mëson), **ngjohna** (ndëgjohemi), **ndajt** (ndejt), **nofshëm** (njofshëm), **nauk** (nuk), **ndrejshe** (ndryshe), **nonën** (nënë), **pëlçeva** (pëlqeva), **puna** (puna), **qetra** (tjetra), **qysh** (si), **rahat** (rehat), **rejten** (riten), **shaum** (shumë), **shamëj** (shami), **shofësh** (shohish) **shejf** (shih), **shku** (shkuar), **shpajën** (shtëpinë), **shkraun** (shkruan), **shtej** (tash), **tauj** (ty), **thkej** (kthej), **vetmë** (vetëm), **vllaj** – **vllavi** (vëllai) etj. Fjalët më të përdorura me shkurtesa janë: faleminderit – **flm**, kalofsh mirë – **klm**, nuk ka përse – **sps**, diçka të re – **dns**, të fala – **tf**, natën e mirë – **natën**, të dua – **td**, të dua shumë – **tdsh**, zemër – **zmr**, domethënë – **dmth**, për shembull – **psh**, fletore – **fl**, tungjatjeta – **tung**, e të tjerë – **etj**, alejkum selam – **as**, energji – **nrg**, ditëlindja – **dtl**, grupe – **gr**, telefon – **tl**, mobil – **mob**, televizor – **tv**, denar – **den**, kilogram – **kg**, fshati – **fsh**, trego – **trg** (kalzo – **klx**), gëzohem – **gz**, detyrë klase – **dk**, detyrë shtëpie – **dsh**, në qoftë se – **nqs**, natën e mirë – **nt**, gjumë të ëmbël – **gjtë**, për shkak – **pshk**, klasa – **kl**, pa lidhje – **pldh**, problem – **prb**, letër – **ltr**, ekziston – **ekz**, kënga – **kng**, internet – **int**, muhabet (bisedë) – **mhb**, mesazh – **sms**, ta zëntë frymën – **tzf**, detyra – **dt**, zemër – **zmr**, gjithashtu – **gjith**, përshëndetje – **prsh**, kalofsh shishët – **klsh**, shkolla – **shk**, shekulli – **shek**, jo – **nck** (Prishtinë; jo – **ncuk**), sekondë – **sec** etj. Shumë fjalë të shkurtuara shoqërohen me numra, që do të thotë shënohen dy-tre shkronja dhe numri.p.sh. të re – **3**, ndonjëherë – **ndo1**, asnjëherë – **as1**, do një të re – **d13** etj.

Mesazhe nga WhatsApp që janë marrë nga celularë:

WhatsApp 1: *Qe po du me shku pak sot ma vone*

A doni me ardh ju

Ju pres

WhatsApp 2: *Hich nuk ishte zort pyetjet ishin pak trenda amen kit na kajn kallzau me te rrethaume ishin*

Un e kisha ne histori

WhatsApp 3: *Hey si je*

A ki me ardhen

Po te pres

WhatsApp 4: *Majr flm taj si je a je mair si kalon.un mair.ce ska asni 3 ka ju dns klm.*

Sot e pash se mke shkrujt.ngjohna flm.

WhatsApp 5: *E bena testin*

Shkum n' kafe

En mrapa nenshkraujtem

Mapa na dhan disa letra ku e kishim pinin per te hij
Ene u hunxhem sicielli nxenes ka ni kompjuter
Ene e shkrajtem emrin mbiemrin ene pinin ci e kishim

45 pyetje kisht kit i bena

Imi knach e vjeçaredhjmje madhe .

WhatsApp 6: *Xhi bojsh mi*

Sa majr ke dal n' foto

A ije majr?

Une n' pune njer n' 7 jom malit.

WhatsApp 7: *Aha de martoheka mo*

Majr plot muhabete mke kallzau

Flm xhi mkujton

Naten.

WhatsApp 8: *A ini majr, si krijni kon, un kismet do vaj si tijem majr sagllaum. A me prejtne.*

Tfala. Tung. Naten.

WhatsApp 9: *A ije majr*

Xhi ka deni tre

Oj dua tet pajs per ni fuston a e begenisish

Se du ta cepi cashtau

Neser du t'shkoj tmar material

Po se di sa tmar

A e begenisish?

WhatsApp 10: *xhi bojsh a ije mejr*

Xhi ka doni se ka tej

Tfala naten

3. Fjalët e shkurtuara në Viber

Viber është një aplikacion që vendoset në telefonat celularë dhe jep mundësi që të komunikohet me anë të të shkruarit dhe bisedës. Kjo kohën e fundit është shumë e përdorur, kurse në vendin tonë vitin e fundit ka marrë përmasa të gjëra. Për tu instaluar *Viberi* në telefonat celularë, telefoni duhet të ketë android (system operativ i telefonave) dhe për të funksionuar *Viberi* duhet të jetë i kyçur internet. Në muajt e parë të këtij viti (2013) u mundësua që *Viberi* të instalohet edhe nëpër kompjuterë, por para se të instalohet *Viberi* në kompjuter, duhet të instalohet në telefon. *Viberi* mund të përdoret për biseda falas

(komunikimi dhe thirrje), dërgim të fotografive etj. Viberin e përdorin gjithkund nëpër botë. Si në të gjitha rrjetat tjera sociale, ashtu edhe në *Viber* kemi përdorimin e gjuhës dhe varietet gjuhësore të ndryshme, dialekte të ndryshme, ashtu siç ndodh me gjuhët tjera, i njëjti fat ndodh edhe me gjuhën tonë. Gjuha e *Viberit* dallon nga gjuha standarde, ku kemi ndryshime të shumta në fusha të ndryshme, shkurtime të fjalëve, fjalë të pa plota, dialektizma, krahinorizma etj. Gjatë vëzhgimeve që kam bërë, kam hasur shumë pak fjalë që i përkasin shqipes standarde, shumica e fjalëve janë fjalë nga dialektet e ndryshme, fjalë të pa plota, duke mos munguar huazimet dhe ndërkombëtarizmat, e sidomos fjalët angleze.

Disa fjalë që përdoren më tepër në *Viber* nga shqiptarët e vendeve të ndryshme: **Ashto** (ashtu), **asnjo** (asnji), **cëlla** (cila), **çashtau** (çashtu), **boheshin** (bëheshin), **dokush** (dikush), **dënihere** (ndonjëherë), **dni** (ndonji), **dajxhët** (dajët), **dhejmta** (dhimbje), **emën** (emër), **gazmova** (gëzova), **gzojsh** (gëzojsh), **gjalín** (djalín), **informau** (informu), **jemja** (imja), **jom – jëm** (jam), **kmejsh** (këmishë), **kan** (qan), **ktive** (këtyre), **knaç** (kënaq), **kom – këm** (kam), **kallxoja – kazoja** (tregoja), **mejr – majr** (mirë), **mirmbroma** (mirëmbërëma), **mar** (marr), **mbroj** (mbrri), **mbejta** (mbyta), **njofe** (njohe), **ndajhena** (ndihemi), **oshte** (është), **oho** (aha), **oni** (ani), **pjagës** (plagës), **përgaditu** (përgatitu), **qon-kon** (qen), **rahat** (rehat), **rajtet** (rritet), **rajm** (rimë), **saunde** (sonte), **shpaj – shpi** (shtëpi), **shkraum** (shkruar), **shom – shaum** (shumë), **shpajna** (shpina), **shohish** (shohësh), **trija** (tëre), **thojna** (thoshim), **udhë** (rrugë), **urdhën** (urdhër), **vnohem** (vonohem), **xhë** (gjë) etj. Interneti është shumë i ri, por ka marrë përhapje të gjerë dhe mbështetet mbi bashkëpunimin e vazhdueshëm të të gjithë rrjeteve të ndërlydhura. (Çepani, 2006:389) Gjuha shqipe që përdoret në internet është ndryshe nga gjuha e shkruar, për arsye të shumta. Jo vetëm që fjalët që përdoren nuk shkruhen në rregull, si duhet të shkruhen, por në të shumtën e rasteve ato edhe shkurohen, vetëm shkruhen disa shkronja të fjalës. Kjo ndodh si pasojë e komunikimit të shpejt ndërmjet njerëzve dhe duke mos humbur kohë fjalët i përdorin shkurtime. Shkurtimi i fjalëve bëhet shprehje dhe më këto fjalë janë shumë të përdorura dhe rrallë shkruhet fjala në tërësi. Në fillim fjalët e shkurtuara janë përdorur nëpër sms dhe arsyeja e shkurtimeve të fjalëve është numri i kufizuar i shkronjave, kur kalohet numri i kufizuar i shkronjave atëherë mesazhi kalon në të dytin dhe paguhet dyfish. Pastaj këto fjalë janë përhapur edhe nëpër programe të tjera të cilët janë edhe pa pagesë, por fjalët e shkurtuara përdoren përsëri.

E njëjta gjë ndodh edhe me programin *Viber* ku përdoret një numër i madh i fjalëve të shkurtra. Viber është shumë i përhapur gjithkund në këtë kohë për të komunikuar. Fjalët më të përdorura në viber: faleminderit – **flm**, kalofsh mirë – **klm**, natën e mirë – **ntm**, pa lidhje – **pldh**, gëzohem – **gz**, të fala – **tf**, gjumë të ëmbël – **gjte**, profesori – **pr**, organizon – **org**, gjithashtu – **gjthsh**, ndoshta – **nd**, shkolla e mesme – **shm**, përshëndetje – **prsh**, çka ban –

kbn, për shkak – **prsh**, tjera – **tj**, fletore – **fl**, trego – **trg**, diçka të re – **d3**, asnjëherë – **as1**,
gjinia mashkullore – **gjm**, gjinia femërore – **gjfm**, gramatika – **gr**, nuk ka gjë – **skxh**, vdis –
vd, numër – **nr**, minuta – **min**, kupton – **kp**, kalofsh bukur – **klb**, puthje – **mpuq**, Tetovë –
8ov, gjumë të shishët – **gjtsh**, mos e prek – **xix**, normal – **nrm** etj.

Disa mesazhe origjinale të marra nga telefonat celularë (me dëshirën e pronarëve të telefonave):

Viber 1: Ne ke ato lidhsat xhi kerkohen ke shembujt nuk ina te sigurt dojshim tet pajsim

Kur jep fjali per te qen ma t' sakt

Se kto xhijon pytje i kina bo pergjigjet

Viber 2: Mejr flm ju si ini? Ska asxho me tyjetra kejt ka ju dns xhi ka??

Majr osht super gjith ditën e shetatjtim

Klm

Viber 3: Majr jam

Ma vendoj at nat

U msau ke une

Heeee

Taj a ije majr

Viber 4: Cishbon

Shkraum cato ampulla

Ke puna jam

Po pi asaj firme zort se ka

Do shoh

Viber 5: A ije majr, e pash foton, ftajra a ja mbush me koka a hija i ka ra.

Mer imi kit, oho ashto i buhet ftera, njer nokshom i hupen. Tf

Viber 6: Pershendetje, far beni a ini kit majr me shendet a kini nxeht, duki per pushime cao cao.

Viber 7: Urime, po kur det shoh dot blej nje dhurate.

Flm shaum shaum

Halis ma ke bo qifin shaum sikur t kishe mar, tej cdo her ije e kujdesshme

Prej krejt personave qe kam taku deri tani ti je ma e kujdeshme

Cdo here mke prek me doni shenje kujdesi kshtu edhe sot flm shum

Ne dulen ndark sot u luhavajtem ene shtej sa erdhem haha

Falemndr shum

Viber 8: Mirmengjesi

Ho mi xhi bojsh

Deni tre?

Paske zon foto tbojsh

Hiche mi se mbare

Viber 9: Oj tete xhi ta ka bo at a mund te ma cesish ne foto en te ma cojsh

A mund te ma cesish a skije vaket

Coma kur de kesesh vaket

Se mduhet

Du ta shoh

Flm

Viber 10: A shtej e ndrove foton

Aha

Kur de kijesh vaket shkrauma cat receptin e tatlis me sode.

Ok

Shtej kur folsha me nonen teme taj mshkraujshe en un I kallxova si mtha taj per tatlin me sode en ajo tha pajte si o.

4.Fjalëte shkurtuara në sms (Shërbimi i Mesazheve tëShkruara – SMS)

Shkurtesa SMS do të thotë Short Message Service - Shërbimi i mesazheve të shkurtuara. Nga epoka digjitale e gjuhës nuk duhet përjashtuar edhe gjuha si mjet komunikimi përmes sms-ve, ose mesazheve me telefoni celulare, që është një mënyrë digjitale komunikimi sepse informacioni i krijuar ka trajtë elektronike. Është fjala vetëm për gjuhën e mesazheve që dërgohen me postë elektronike, ose nëpërmjet sms-ve e cila ka kohë që i është larguar asaj tradicionale të letërkëmbimit. (Dajo, nëntor 2012)Siç theksuam edhe më lartë fjalët me shkurtesa përdoren shumë edhe nëpër Shërbimin e Mesazheve të Shkruara - SMS. Për të shkruar një sms numri i shkronjave është i kufizuar dhe çdo mesazh kushton, për këtë arsye vjen deri te shkurtimi i fjalëve, që të shkruhen më shumë fjalë.Mesazhet përdoren shumë tashmë jo vetëm përmes rrjeteve telefonike, por edhe përmes internetit (MSN, Skype, Facebook etj).Fjalët e shkurtuara në sms i kemi për arsye se një sms përmban 160 karaktere ku hyjnë: shkronjat, shenjat e pikësimit, hapësirat dhe për të arritur që të shkruhen më shumë fjalë ka ardhur deri te shkurtimi i fjalëve. Fjalët me shkurtesa që do ti përmendim janë marrë nga disa telefona celular për një periudhë tre mujore.Këto janë fjalët më të përdorura që janë hasur në sms-të e pranuara: autobus – **bus**,faleminderit – **flm**, kalofsh mirë – **klm**, nuk ka përse – **sps**, diçka të re –**dns**, të re – **3**, të fala - **tf**, natën e mirë – **natën**, problem – **prb**, të dua – **td**, të dua shumë – **tdsh**, zemër – **zmr**,shqip – **shq**, mesazh – **msg**, vetëm – **vtm**, bjerë

fletore – **bje fl**, temperaturë – **temp**, ta zëft frymën – **tzf**, viti – **v**, natën e mire - **natm**, puthje - **puc**, shkruan - **shkr**, kënaqet - **kn**, frizur -**fr**, thirrja për propozime - **thpp**, informatë - **info** etj.

3.4.Fjalët e shkurtuara në msn

Me zhvillimin e teknologjisë, sidomos me paraqitjen e internetit dhe celularëve ka ndryshuar mënyra e të shkruarit, ku karakteristike janë shkurtime dhe simbolet. (Ibrahimi,2012:133)Siç ndodh te të gjithë programet tjera, ashtu edhe në gjuhën e MSN-ës ka fjalë që përdoren me shkurtesa.MSN - Mesenxher është një program komunikues. Mesenxheri u mundëson përdoruesve,përdorimin e tij në shtëpi dhe kudo, si dhe ai lejon më shumë komunikime, me anë të së cilit mund të kryhen të gjitha obligimet apo detyrat prej në shtëpi ose kudo që të jesh.Sipas studimeve që janë bërë në lidhje me gjuhën e mesenxherit, gjuha e mesenxherit është gjuhë e folur që realizohet përmes të shkruarit.Nga rezultatet që dalin për gjuhën e mesenxherit në të vërtetë nuk është gjuhë e shkruar,por është gjuhë që shkruhet. (Paçarizi, 2006:177)Shumë fjalë që përdoren gjatë komunikimit me mesenxher ndryshojnë nga fjalët që shkruhen, arsyeja është se përdoren fjalë të shkurtuara që më shpejtë të komunikojnë.Ndryshon nga gjuha e mesazheve të shkruara, sepse te mesazhet e shkruara përdoren shenjat, ndërsa te gjuha e mesenxherit shenjat shprehen me anë të figurave.Programi është vizual dhe për qëllime të mira dhe baza e mesenxherit është për të parashikuara rrethin dhe obligimet përreth. Tashmë me këtë programi është aq e lehtë për t'u ofruar shumë pranë punëve dhe nevojave që i kryen nëpërmjet mesenxherit .Këtu do të bëjmë fjalë për gjuhën e mesenxherit, veçanërisht fjalët që përdoren me shkurtesa gjatë komunikimit në mesenxher.Fjalët e shkurtra që janë përdorur më tepër janë: faleminderit - **flm**, kalofsh mirë - **klm**, natën e mirë - **natën**, internet - **net**, numër- **nr**, mesazh - **sms**, s'ka për herë - **sph**, të dua - **td**, të dua shumë - **tdsh**, telefon - **tel**, të fala - **tf**, zemër – **zmr**, nuk pajtohem plotësisht - **npp**, pajtohem – **p**, pajtohem plotësisht – **pp**, e saktë – **es**, pa saktë – **ps**, informatë – **info**,televizor – **tv**, shkollë – **shk**, natën e mirë - **ntm** etj.Në tabelë do të shohim se sa janë përdorur këto fjalë që janë marrë nga një adresë emesenxherit për një muaj.

Kreu i katërt

PËRDORIMI I
EMOTIKONEVE NË
KOMUNIKIMET
ELEKTRONIKE

1.Përdorimi i emotikoneve në komunikimet elektronike

Miliona njerëz po përdorin gjithnjë e më shumë gjuhën e "Emoxhi" (Emoji). Me fjalë të tjera, buzëqeshje dhe simbole të ndryshme.


Emoxhi është në të vërtetë gjuha e emocioneve dhe vitet e fundit është bërë gjithnjë e më e përhapur, jo vetëm në internet, por edhe në telefona celularë dhe tableta. Duke vepruar kështu, ne e dimë se si filluan të gjitha. Në fillim, njerëzit po vizatonin në muret e shpellave, në ditët e sotme në vend të drurit ose gurit të karbonizuar, ata mbajnë në duar telefonat inteligjentë. Dhe motivet kanë ndryshuar. Nuk ka më vigan, pishtarë dhe shtiza, por ka heronj të ndryshëm vizatimorë dhe simbole humori.

Të gjithë këta personazhe, në qindra, quhen gjuhë emoxhi ose emotikon. Emri rrjedh nga dy terma anglisht: "emocion" (emocion), dhe fjala "ikonë" (ikonë ose shenjë, simbol).

Gjuha e emotikoneve është një gjuhë e komunikimit dixhital, e disponueshme në të gjitha aplikacionet. Mund të instalohet si një gjuhë shtesë në të gjitha pajisjet, dhe rrjetet sociale janë përmbytur me ikona dhe shenja të ndryshme, në atë masë sa është pothuajse e pamundur të përcaktohet numri i saktë i tyre. Janë zyrtarisht 722 simbole. Ju fitoni kaq shumë prej tyre kur instaloni në Android. Ka gjithçka nga ikonat: nga buzëqeshje të njohur, deri tek skiatorët e animuar dhe syzet e shampanjës, madje dhe buzëqeshjet dhe ikonat gej!

Ekspertët kanë teza të ndryshme mbi avancimin e simboleve digjitale, të cilat përdoren nga një numër në rritje i njerëzve në komunikim. Disa besojnë se kjo prirje ka një efekt negativ në zhvillimin e gjuhëve normale, kryesisht me shkrim. Njerëzit që janë "vendas" të gjuhës së tyre dixhitale, në të vërtetë janë dembelë të shprehur me fjalë.

Tina Ganster, një ekspert gjerman në psikologjinë sociale, pretendon se emotikonët janë "një mënyrë krijuese për të shprehur veten përballë kufizimeve të komunikimit dixhital". Ajo krahason emotikonin me komunikimin e përditshëm jo-verbal në realitet. Mimika, gjuha e trupit, intonacioni në të folur zakonisht nuk përcillen në mesazhet me tekst. Në mesazhet e shkurtra në internet, këto ikona janë mënyra e vetme për të shprehur emocione.



"Të gjitha këto simbole, në radhë të parë, shërbejnë për të shprehur më shumë emocione. It Është e mundur të shprehni ironi ose sarkazëm dhe kështu të shmangni keqkuptimet e mundshme në komunikim", thotë Tina Ganster. Nëse në bisedë me dikë thoni " Ftojeni nënën tuaj në një festë" kur flisni me dikë dhe përfundimisht me sy, mund të dëshironi të shprehni atë lloj emocioni edhe në komunikimin dixhital. Në platformat chat ose në mesazheve të menjëhershme, kjo mundësohet nga gjuha emotikoni. Me fjalë të tjera, ikona të shumta lejojnë komunikim të ngushtë atje ku mungon. Eksperti i gjuhëve Peter Schlobinsky nga Universiteti i Leipzig nuk beson se përdorimi masiv i emotikonëve mund të rrezikojë përdorimin e gjuhës. "Këto simbole nuk janë të pranishme në të gjitha segmentet e jetës, ato janë të disponueshme për ne në vende të caktuara, kur dërgojmë mesazhe të shkurtra, për të biseduar, në forume."

2.Karakteristikat e përdorimit të shenjave dhe simboleve

Në komunikimet elektronike përveç fjalëve që përdoren, kemi dhe përdorim të gjerë të shenjave, simboleve (emoticones) që shkruhen në forma dhe mënyrat të ndryshme. Sot kemi parasysh që fjalët dhe ndjenjat shprehen edhe nëpërmjet çatëve dhe internetit. Përdorimi i tyre është për arsye se ndjenjat nuk mund të shprehen me fjalë dhe shprehen me shenja dhe po ashtu një mundësi për një komunikim më të shpejtë.

Këto lloj shkurtimesh janë bazuar në fjalë dhe numra, emotikonet mbështeten në efekte pamore të formave dhe të kombinimit të tasteve të tastierës për të shprehur një gjendje emocionale që s'mund të jepet me fjalë. (Çepani, 2006:397)

Shenjat hasen shumë shpesh në biseda të çastit dhe kjo ndodh te të gjitha gjuhët, e njëjta gjë ndodh edhe në gjuhën shqipe, ku kemi përdorim të madh të shenjave. (Zurijeta 2014:59).

Disa të tilla që hasen më dendur:

1.Me fal se sekem ndej tel. Flm shum, u sos puna ashtu du them mem pejt.. Klm cao 😊

2. Jo un hala jo 😊

Shiqir tfala bonu shaum shaum. 😊 3.En ato te urdhnoj kur en si vu mteket

Se dij



Ne ti bojn vet

Kush dose

Shumë shenja që përdoren nëpër komunikime elektronike shprehin ndjenja apo emocione që nuk mund të përshkruhen me fjalë dhe shumë më lehtë dhe më shpejtë shfaqen me shenja, qofshin ato ndjenja gëzimi, kënaqësie, hidhërimi, mllef, inati etj.


Shenjat dhe simbolet janë të përhapura në masë të madhe në komunikime elektronike dhe shenjat më të përdorura janë: :) - buzëqeshje, :(- pikëllim etj, që do ti shohim se sa përdoren këto shenja në komunikime elektronike. Tabela është si rezultat i një ankete që është bërë nga një grup i caktuar i personave .

Nga këto të dhëna vërejmë se të gjithë të anketuarit e përdorin shenjën :) – buzëqeshje, 72 % të të anketuarve e përdorin :* - puthje, <3 – zemër 49%, :(- pikëllim 40%, ;) – shkelje e syrit dhe :D – gojëhapur 36%, :P – nxjerje e gjuhës 19% dhe 15% :-) – më vjen mirë.

Në nivel botëror përqindja e përdorimit të emotikoneve është si vijon:

Këto shenja dhe simbole edhe pse ndihmojnë për një komunikim më të shpejtë, po ashtu edhe ndryshojnë gjuhën sepse në të shumtën e rasteve fjalët zëvendësohen me shenja dhe duhet të merren masa që mos vijë deri te dëmtimi i gjuhës.

Shenja	Të anketuarit	%
:) – buzëqeshje	47	100
;) – shkelje e syrit	17	36
<3 – zemër	23	49
:D – gojë hapur	17	36
:(- pikëllim	19	40
:-) më vjen mire	7	15
:P – nxjerje e gjuhës	9	19
:* - puthje e zjartë	34	72



Pra kanë ndryshuar metodat. Dikur shkruheshin letrat e dashurisë dhe mendohej të viheshin në letër fjalët e zemrës. Njerëzit që nuk dinin të shkruanin i thoshin një shoku ose

një personi tjetër, më shkruaj një letër. Po të bëjmë një krahasim ato, ishin si puna e serenatave që bëheshin nga dikush tjetër, në emër të dikujt tjetër. Letrat kanë pasur një karakter të tillë të foluri që në shkrim duheshin figura letrare siç mund të përmendim: *si mu dogj zemra, jam i përvëluar* etj. Ndërsa rininë e sotme e karakterizon shprehja më e lirshme, madje ndodh që janë më vulgarë se dikur. (Ibrahimi, 2008:169) Shenjat shprehen me kombinimin e dy e më tepër shenjave të pikësimit që tregojnë disponimin e fytyrës thjeshtë dhe shpejtë, duke shprehur gëzim, hidhërim, habi, tallje etj. Fjalët i'u lenë vendin simboleve që quhen Emoticons⁶(emocion – ndjenjë dhe ikon –ikonë), simbole të përfituara nga bashkimi i dy-tre shenjave të pikësimit. (Dajo, nëntor 2012) Por ato mund të zëvendësohen edhe me bashkërendime shkronjash e numrash. Simbolet janë shumë të përdorura në komunikimet elektronike, qofshin ato ***në Sms, Msn, Viber, WhatsApp, Skype, Facebook*** etj. Ato përdoren nga të gjithë përdoruesit e komunikimeve elektronike, e sidomos nga të rinjtë. Ndërsa këto lloj shkurtime janë bazuar në fjalë dhe numra, emotikonet mbështeten në efektet pamore të formave dhe të kombinimeve të tasteve të tastierës për të shprehur një gjendje emocionale që s'mund të jepet me fjalë. (Çepani, 2006:397) Sa i përket vendit tonë simbolet kanë filluar të përdoren shumë vonë në krahasim me vendet tjera. Ka edhe shumë simbole që shfrytëzohen për imitim të sendeve, p.sh. simboli (☹) shpreh një *gotë kafe*, [☹] – *një gotë ujë*, ><>< *sheqera (bonbona)*, [_____] *shtylla të futbollit* etj. (Drinčić 2012:73) Prej periudhe në periudhë simbolet kanë filluar që sa më shumë të përdoren dhe të bëjnë vendin e tyre nëpër komunikime elektronike, janë bërë si një pjesë e gjuhës dhe pa to rrallë mund të hasim ndonjë shkrim, ato tashmë i gjejmë gjithkund dhe kudo. Ja disa të tilla:

: -) (-: *Do takohemi?*

: -) *Gëzohem - Me vjen mirë*

: -)) *Gëzohem shumë - Me vjen shumë mirë*

; -) *Të shkel syrin me “dinakëri”*

: -> *Buzëqesh me ironi*

> : -> *Buzëqesh djallëzisht*

: - (*Më vjen keq*

: -D *Qesh - Buzëqesh*

: -O *Jam i habitur*

: -* *Puthje*

: @) *Derrkuc*

: - {} *Kam të reja*

:--~) *Jam ftohur*
 :-ll *Jam me nerva*
 %-) *Me ka ikur truri*
 :-ç *Po e mendoj*
 :-& *Ngeca. S'mund të flas*
 O:-) *Unë s'bëra asgjë*
 :'- (*Jam i dëshpëruar*
 :-@ *Ulëras*
 X:-) *Kam humbur toruan*
 :-X *Ngela pa fjalë (pa zë)*
 :::-) *Kam sy vetëm për ty*
 62
 :-+ *Të betohem*
 :-)--- *Me thuaq ndonjë gjë tjetër*
 :-)- - *Mbylle – Mjaft më*
 @:-| *Me ngeli mendja*
 :-| *Jam indiferent*
 :-{ *Më vjen keq*
 :-E *Do të të kafshoj*
 :-<> *I çuditur*
 :-v *Po flas*
 :-Q *Jam konfuz*
 :- I *I vendosur*
 : '(*Thanë*
 : - # *Mos i tregoni askujt*
 8-| *Budalla*
 [:-) - “ *Jam i qeshur, i kënaqur*
 :-(ë - *Jam i mërzitur, i pikëlluar. (Dajo, nëntor 2012)*
 (@) *Fytyra e maces*
 (*) *Yll*
 :-| **apo:** | *Zhgënjyer*
 !&! *Në bashkëpunim me njeri tjetrin*
 (°) *Jam i mbrojtur nga të dy krahët*
):< *Mu ka fiksuar!!!*
 @_! *I ka shkelur rrota bishtin*

%% Se luan as topi

NDAL,,,zonë private

: - \$ apo: \$ Siklet

* -) Duke menduar

8-) Sy mali

{ } Përqaftim i majtë

: - * Tregimi sekret

: ^) Unë nuk e di

<: o) Partia

| -) Fle

63

{ } Përqaftimi djathtë

(^) Tortë për ditëlindje

(&) Fytyrë qeni

<3 Zemër

:-D apo :d - Me gojë të hapur

-S ose: s Trazuar

:-P apo: p Nga gjuha

(H) apo (h) Nxehet

(A) apo (a) Engjëll

(X) apo (x) Vajzë

(P) apo (p) Kamera

(L) apo (l) Zemra e kuqe

(F) apo (f) Lule

(K) apo (k) Buzët e kuqe

(O) apo (o) Orës

(C) apo (c) Kafe

(Z) apo (z) Djalë

(I) apo (i) Llambë drite

Këto janë disa simbole që përdoren në komunikimet elektronike nëpër rrjeta sociale,disa shprehen me shenja të pikësimit, e disa të tjera me shenja të pikësimit duke u kombinuar me shkronja.Shumica e simboleve që janë të kombinuara me shkronja, ku bashkë me shenjat e pikësimit vendoset shkronja e parë e fjalës nga gjuha angleze dhe mbeten të përdorura edhe te shqiptarët dhe shumë popuj të tjerë.

P.sh. (L) apo (l) – **love** – *dashuri*, ku tregon shenjën e zemrës – **zemër e kuqe**, (F) apo

(f) – **flor** – *lule*, (K) apo (k) – **kiss** - *buzët e kuqe* (puthje), (H) apo (h) – **hot** - *nxehhtë*, (A) apo

(a) – **angel** – *engjëll* etj.

Disa shembuj që shpesh hasim simbole në komunikime elektronike:

1. *Urime 8 marsi.*

Faleminderit Shum :)

Gjithashtu edhe Juve :)

2. *Mirr Faleminderit si je ti :) ? Mamii shum mirr asht, tej si je? Ngjohna cdo ditt :)*

Faleminderitt shumm tfala ke edhe tii :)

3. *Si psh kush :-)*

Poo ta thashh mii

:D

:-S

Amen e xhete :))))))

Hahahaha a e sheff :P

Eeee ku e kem 5!? :P

:D

Ke ditari I shkolles !!!!! :-B

Phaaaaa un kursem ndor :P

Ojj hajj kiss se de fajki int

4. *Ju ku ini ?!*

Falemideritt shaum shaum

Une n' shpaj ka sahati 2 erdha

Sps suksese provimin qeter

Amin inshallah :)

5. *Si je a je majr*

xhi ka deni se ka ju

tfala klm

:)

mejr tej mejr ije?

Asxho hic si gjiith me tvetra ka tej?

Nejse bye:)

6.Urime festen :-)

Falemnderit shummmm urime edhe juve (-: :-*

7. Cbon mi :-)?

A de shkojm nditlindje sonte? :D

Bej redaktimin e revistes. Jo se nuk kam kohe. :-(

Haj se deta boj une redcaktimin vec ija tej :P

Ok atehere mos tet pengoj ma shum shifemi

: -*

Naten :-)

Naten ;-)



7. cbon mi a je mejr?

Mejr lock tej si je a je mejr ?

Po mejr ka met mo :- (;-(

Pse ckie????

Nonstop npun u mbejtem, ndash mo ene pak ene sos shiqir :(:(:(

8. hey babe ka ije? :)

Ce ke pubi tej ka je cbon?

Nshpej pot hash kot tshof ka je.. :S

Ok G I <3 U

<3 you too

9. ku je mi moooo :@:@:@

Ce dal prejt.

Po haj mi se u thajta :(@

Mejr cee zdripi shkallve

Oni haj ce tpres posh ene shejf rej nja 2 dit shkallve :@

Hahahhah pjass ;-) ;-) ;-)

10. A de jesh lir mavon ? :-)

Pse mi? :) :)

Tpejm kafe? :-)

Hahah oni mi une thash pale pse

11. Calushhh cbon?

Ce locko rej cektu bezdi :(

Pse be a nuk trejet agje ;)

Luj luj tej :(:(

Haha rej be agje cde bojsh ktu :D

12. nuk mi tamom pun de vi ene une ;)

Flm ditush :) <3

Rej rahat ;) ;) ;)

13. pse mi cish u bo ;(

Asen asen kot mendova ashtu krejt nregull o :):):)

Ok jam rahat ene une tahej :D:D:D

Naten kiss :*:*:*:*:*

14. hey <3 cish bon?

Ce <3 shof tv ene de dal ene pak

Ok shejfena ateher :*:*:*

Shejfena :* <3

3. Përdorimi i shenjavenë komunikimet elektronike

Në komunikime elektronike simbolet shpesh zëvendësohen edhe me shenja, tash më me zhvillimin e teknologjive informative, te të gjitha pajisjet është e mundshme që të instalohen shenjat e ndryshme, që në vend të shenjave të pikësimit të bashkuara me shkronja,apo dy e më tepër shenja të pikësimit, mund të paraqitet vetëm me një shenjë.Këto shenja janë shumë të përdorura në komunikime elektronike, përdoren nga njerëz të popujve të ndryshëm pa dallim moshe. Ashtu i përdorin edhe shqiptarët anembanë botës.Shenjat zënë një vend të rëndësishëm në komunikime elektronike apo të themi në biseda të çastit, ato shprehin një ndjenjë të fytyrës apo mimikë që nuk mund të thuhet me fjalë dhe shprehet me anë të shenjave.Përdorimi i tyre është për arsye se ndjenjat nuk mund të shprehen me fjalë dhe shprehen me shenja dhe po ashtu një mundësi për një komunikim më të shpejtë.Këto lloj shkurtimesh janë bazuar ne fjalë dhe numra, emotikonet mbështeten në efekte pamore të formave dhe të kombinimit të tasteve të tastierës për të shprehur një gjendje emocionale që s'mund të jepet me fjalë. (Çepani, 2006:397).

Statistikat e publikuara nga Emoticon-Tracker, bazuar në përdorimin e emotonëve në rrjetet sociale siç është Twitter, tregojnë se emocionet dhe ikonat më të njohura janë:

- zemra e kuqe (e përdorur 241 milion herë),

- buzëqesh me lot gëzimi (152 milion herë)
- një buzëqeshje e zakonshme (e qeshur) (e përdorur 85 milion herë).

Këta janë të gjithë pasardhësit e fytyrës origjinale të buzëqeshjes, e cila dikur ishte shtypur ose shtypur duke përdorur pikësimin :-). Historia e buzëqeshjeve fillon në vitin 1982. Për herë të parë, ky kombinim i shenjave përdoret nga profesori Scott Falman nga Universiteti Carnegie Mellon. E shqetësoi që kolegët e tij, komentet e postuara në forume, ishin keqkuptuar. Kllapat me dy pika, minus dhe të mbyllura janë bërë një simbol i buzëqeshjeve të komunikimit dixhital brenda natës.

Emotikonet dhe kombinimet e tyre

Aspekt me mjaft interes në këtë lloj komunikimi paraqet edhe mënyra e shkrimit me anë të shenjave ikona ose emotikonet. Secila prej tyre shpreh një ndjenjë të caktuar. Komunikimi mund të jetë thjesht vetëm me anë të shenjave ikona (emotikone) ose me kombinim të tyre dhe shkrimit a shkurtimeve. Këtë mund ta konkretizojmë me disa raste.

R. B. wowww ky po q esht propozim 😊

B. T. ahahahahaaa 😂

R.B 😊

B. T. esht si epidemi 😬😬

A. B. M vure n seder... E bera like 😍

Mbështetur në emotikonet e skeduar rezulton se ato që përdoren më tepër në komunikimin e të rinjve janë këto shenja ikonike. Kjo lloj mënyre fillon ta vështirësojë të kuptuarit e mesazhit nga një person i tretë, pra komunikimi fillon të kodifikohet më tepër. Kodi bëhet edhe më i vështirë përt'u dëshifruar kur kombinohen ikonat me shkurtime e shkrimit. Nga ana tjetërjo të gjithë përdoruesit e facebookut mund të jenë në gjendje “të zbërthejnë” mesazhin e koduar dhe të komunikojnë me këtë lloj kodi, nëse nuk njohin vetë mënyrën e të shkruarit me këto shenja.Për realizimin e tyre si të tilla bëhet një kombinim me dy a më shumë taste në tastierën e kompjuterit. Po e konkretizojmë me disa shembuj të përdorur. (Brame 2014:51)

Tabela 1. Kombinimi i tasteve të kompjuterit për të formuar ikonën përkatëse.

Kombinimi i tasteve të tastierës	Ikona e përfutur	Domethënia e ikonës
:)		Buzëqeshje
:(		I trishtuar
:-*		Puthje
:O		I habitur
:D		Shumë i qeshur
:P		Tallje, përqeshje
;)		Shkelje syri, gjithçka shkon mirë
>:(		I zemëruar, i inatosur
o,O		Konfuz, i hutuar
<3		Zemër, i/e dashur
:/		I pasigurt
O:)		Engjëll

Brenda këtij kuadri kodifikimi i komunikimit merr natyrë tjetër. Komunikimi nuk bëhet me shkrim, me ikona, por me shenja të veçanta që krijohen nga tastiera e kompjuterit dhe që mbajnë një domethënie e caktuar të emotikonit. Kodifikimi në këtë rast bëhet më specifik pasishenja ikonë tashmë zëvendësohet me shenja më të ndërlikuara që e krijojnë atë dhe në këtë mënyrë zbërthimi i kuptimit bëhet më i vështirë. Ky lloj mesazhi i shkruar shërben për personat që njohin kodin përkatës dhe që mund të komunikojnë me të. Në rastin tonë, mesazhi kodifikohet për të tjerët që nuk zbërthejnë domethënien e shenjave. Pjesëmarrësit në këtë shkëmbim informacioni merren vesh sepse janë identifikues dhe zbërthyes të të njëjtit kod. Nga analizimi i mesazheve të shkëmbyera në komunikimin po ilustrojmë disa shembuj.


Tabela 2. Domethënia e shenjave të mesazheve

Shenja e koduar	Domethënia
:~))	I lumtur me të vërtetë
:~((	Vërtet i trishtuar
:~s	Nuk di çfarë të them
:~O	Mos qaj
:~* :~* <3	Të puth zemër
:~* :~* :~* :~*	Puthje puthje
,~)	Buzëqesh duke shkelur syrin

Shenjat që përdoren më shpesh në komunikime elektronike

	:~) o :)		:~D o :d		(X) o (x)		(Z) o (z)	S e c r e t o s		Sonriente	:^)
	:~D o :D		:~P o :p		{f}		{}			Cubierto	(pl)
	:~) o :)		:~(o :(		(K) o (k)		(^)			X-Box	(xx)
	:~S o :s		:~ o :		(L) o (l)		(U) o (u)			'Tortuga	(tu)
	:~(		:~\$ o :\$		(P) o (p)		(G) o (g)			Cigarro	(ci)
	(H) o (h)		:~@ o :@		(F) o (f)		(W) o (w)			Dedos cruzados	(yn)
	(A) o (a)		(6)		(@)		(~)			Llúvia	(st)
	:~#		8o		(T) o (t)		(&)			Truenos	(li)
	8-		^o)		(8)		(I) o (i)			aplausos	(h5)
	:~*		+o(		(*)		(S)			cara de velocidad	(brb)
	<o)		*~)		(O) o (o)		(E) o (e)			platos xinos	(ll)
	~)		8~)		(sn)		(M) o (m)				
	(Y) o (y)		(C) o (c)		(pi)		(bah)				
	(B) o (b)		(N) o (n)		(au)		(so)				
	:~[o :[		(D) o (d)		(um)		(ap)				
	(mo)		(mp)		(co)		(ip)				

Animals & Nature



Food & Drink



Activities



Travel & Places



Flags



Objects






Shenjat që më shpesh përdoren në komunikime elektronike

1		I buzëqeshur
2		I mërzitur
3		Gojëhapur
4		Dreq
5		I përgjumur
6		Nxehtë
7		Duke menduar
8		Befasi
9		I shqetësuar
10		Duke qarë
11		Unë nuk e di
12		I zhgënjyer
13		I zemëruar

Shenjat hasen shumë shpesh në biseda të çastit dhe kjo ndodh te të gjitha gjuhët, e njëjta gjë ndodh edhe në gjuhën shqipe, ku kemi përdorim të madh të shenjave.P.sh






Shumë shenja që përdoren nëpër komunikime elektronike shprehin ndjenja apo emocione që nuk mund të përshkruhen me fjalë dhe shumë më lehtë dhe më shpejtë shfaqen me shenja, qofshin ato ndjenja gëzimi, kënaqësie, hidhërimi, mllef, inati etj.

ANKETIMI QË LIDHET ME PËRDORIMIN E SHENJAVE DHE EMOTIKONEVE NË POROSITË ELEKTRONIKE

1.Të anketuarit sipas gjinisë:

a)100 meshkuj

b)100 femra



2.Të anketuarit sipas moshës :

a)15-17 (50 të anketuar)

b)19 -22 (50 të anketuar)


c)22-25 (50 të anketuar)

d)25-30 (25 të anketuar)

e)30-...(25 të anketuar)

Të anketuarit sipas moshës:

■ 15-17 vjet ■ 19-22 vjet ■ 22-25vjet
■ 25-30vjet ■ 30-...




3.Pse përdoren shenjat dhe simbolet në internet?

- a) Është më i lehtë komunikimi- 80 të anketuar
- b)Për të komunikuar shpejtë-70 të anketuar
- c)Tregojnë ndjenja-50 të anketuar

Pse përdoren shenjat dhe simbolet në internet?


■ Është më i lehtë komunikimi
■ Për të komunikuar shpejtë
■ Tregojnë ndjenja



4. A përdoren shpesh?

Po – 200 të anketuar

Jo-0 të anketuar



5.Cilat simbole i përdorni më shumë?

:) – buzëqeshje

;)- shkelje e syrit

:D – gojë hapur

:(- pikëllim

:P – nxjerrje e gjuhës

:-) më vjen mire

<3 zemer

:* - puthje e zjarrtë **200 personat që anketova unë , këto lloj shenjash dhe emoikonesh i përdorin më së shumti.**


6.A mendoni ti përdorni edhe në të ardhmen?

Po -150

Jo-50

A mendoni ti përdorni edhe në të ardhmen?

Po Jo




7.A dëmtohet gjuha me përdorimin e shenjave?

a)Pak 50 të anketuar ; b)Shumë-130 të anketuar; c)Aspak-20 të anketuar;

A dëmtohet gjuha me përdorimin e shenjave?

Pak Shumë Aspak



Nga gjithë anketa në përfundim na del se shenjat dhe simbolet kanë përdorim të gjerë dhe të shpeshtë në komunikime elektronike dhe ende përdoren dhe përhapen edhe më shumë dhe sipas të anketuarve do të vazhdojnë të përdoren edhe në të ardhmen.

Kreu i pestë

RAPORTI

GJUHË STANDARDE –

E FOLMJA URBANE

RAPORTI GJUHË STANDARDE – E FOLMJA URBANE TEK STUDENTËT

Gjithsesi shtrohet pyetja, a mund të jemi të kënaqur nga niveli i përvetësimit të gjuhës letrare dhe kulturës gjuhësore te nxënësit, studentët dhe në përgjithësi të popullatës shqiptare? Dhe ku duhet t'i shohim shkaqet për një ngecje të tillë?

Nga gjendja faktike dhe reale që mbretëron në shkollat, fakultetet dhe institucionet nuk mund të jemi të kënaqur dhe lëshimet duhet t'i kërkojmë si në sistemin tonë arsimor, ashtu edhe në kujdesin tonë ndaj gjuhës letrare. Andaj në shkollat tona paraqitet edhe problemi tjetër: shpjegimi i raporteve midis gjuhës standarde dhe dialekteve. Gjuhën që e përvetëson fëmija në shkollë, nuk është e njëjtë me gjuhën që e përdor në familje ose në rrethin më të ngushtë. Për fëmijën gjuha e rrethit është parësore, gjuha letrare vjen pas asaj popullore. E folmja është gjuha e tij amtare. Me ndihmën e tij ai më pastër dhe më lehtë e mëson botën dhe i shpjegon emocionet dhe dëshirat e tij. Me hyrjen e tij në shkollë, bota zgjerohet, plotësohet dhe komplikohet. Dituritë e reja kërkojnë komunikim më të pasur dhe më të ndërlikuar gjuhësor, ku gramatika e të folmes së tij nuk i ndihmon më (Ibrahimi 2012: 121-122).

Këtë më së miri e shpjegon D.Corson, i cili vëren se gjatë kalimit të fëmijëve nga familja në shkollë ata i shmangen ndikimit të fuqishëm të familjes dhe të rrethit shoqëror, ku përdoret një variant ligjërimitor i ndryshëm nga varianti standard që kërkohet në shkollë, gjë që bën që te një pjesë e tyre të hasen anomali në përshtatjen me mjedisin e ri ligjërimitor dhe , përgjithësisht, mossuksese në përvetësimin e disiplinave mësimore. (Corson 1990:17).

Përveç kësaj, fëmija përjeton edhe ndryshime puberteti, që paralelisht e tërheq në pasiguri gjuhësore. Këtë pasiguri gjuhësore mund ta ilustrojmë me dy raste: Në të parin një nxënës i cili ka qenë duke qarë, nuk i ka treguar arsimtarit pse qanë, kurse shoku i tij shpjegoi se "Ka frikë mos ta qosh të flas në gjuhën letrare, andaj hesht". Ose rasti i dytë kur një nxënës sapo i shpërngulur nga viset rurale në qytet, nga dita e parë në shkollë vjen i zhgënjyer dhe me lot në sy, i tregon prindërit se aspak nuk e ka kuptuar mësuesen. Arsytet e këtij mossuksesi qëndrojnë, ndër të tjera, edhe në vështirësinë e këtyre fëmijëve për të përvetësuar normat e gjuhës standarde, apo, siç thuhet ndryshe në literaturën sociolinguistike, në "inkompetencën gjuhësore" të fëmijës.

Nga kjo mund të përfundojmë se fëmijët e qytetit janë më të gjallë, më komunikativ dhe flasin më lirë. Ndërsa fëmijët nga fshatrat pak dallohen janë më tërheqës, më të heshtur me

përpikëri u përmbahen fjalëve dhe shënimeve të mësuesit, zakonisht i mësojnë përmendësh. Kjo do të thotë, se në shkollat e qytetit funksionon më mirë gjuha letrare, edhe pse edhe aty kemi oscilime, sidomos në dallimet klasore të prindërve.

Por edhe pjesa më pak e shkolluar e popullsisë ndodhej nën një ndikim të pandërprerë e të përditshëm të shtypit të shkruar, të radios e më pak të televizionit. As sot fshati, me gjithë disa zhvillime negative, si izolimi, largimi prej tij i njerëzve të arsimuar, premiset për shtimin e numrit të njerëzve me nivel shumë të ulët shkollimi, mungesa e librit dhe e shtypit të shkruar, nuk mund të themi se do të shërbejë si shtrat për ruajtjen apo kultivimin e të folmeve në trajtën e tyre arkaike. Nga ana tjetër, as qytetet nuk janë më aq homogjene si më parë; lëvizjet e mëdha të popullsisë prej zonave të thella të vendit drejt qyteteve të mëdha si Shkup, Tetova, Gostivari etj. kanë sjellë një përzierje të tillë ligjërimesh e të folmesh, që na bën të pohojmë se qyteti nuk është më vatër ekskluzive e ligjërimit bisedor letrar. Pra, edhe në qytet shtresa të caktuara të popullsisë vijojnë të përdorin ligjërimin e shkujdesur, apo ligjërime dialektore.

Në historinë e gjuhësisë shqiptare, pas viteve 1990 ky fenomen u paraqit në forma të reja diskutimi. E pashmangshme ka qenë *tematika e përdorimit të dialekteve dhe rivlerësimi i çështjes së gjuhës si “çështje e kulturës”*. Gjatë kësaj periudhe nuk ishte problematike dhe shqetësuese përdorimi i paskajores, pasqyrimi i gjatësisë dhe shkurtësisë së zanoreve ose dukuri të tjera, por problem i vërtetë shqetësues u bënë: pakujdesia e theksuar ndaj gjuhës, gabimet pa fund, vërshimi i fjalëve të huaja etj. (Ymeri 2002:54).

Studentët. të edukuar në shkollë më frymën e zbatimit të rreptë të normës dhe të përdorimit të rreptë të gjuhës standarde janë dëshmitarë të kësaj atmosfere të re. Si e perceptojnë ata këtë realitet. Cili është mendimi i tyre? A ekziston një prirje drejt standardizimit të shqiptimit dhe nëse po, cili është modeli i shqiptimit letrar? Një konceptim i tillë i raporteve midis gjuhës standarde dhe ligjërimeve dialektore lejon që për shkollën të ndërtohet një strategji gjuhësore më elastike dhe më reale. Në thelbin e kësaj politike gjuhësore, të cilën do të parapëlqenim ta quanim *makropolitikë*, për arsyen se ndërtohet në shkallë kombëtare, do të qëndronte konceptimi i varianteve gjuhësore të shqipes si segmente të një kontinumi, në të cilin për qëllime studimi nga pikëpamja funksionale mund të dallohen: (1) *gjuha standarde librore*; (2) *gjuha standarde e folur*; (3) *ligjërimi i zakonshëm bisedor*, i cili synon më shumë nga gjuha standarde; (4) *ligjërimi i shkujdesur*, i cili përputhet më shpesh me dialektin. (Shkurtaj-Mamushaj 1998:60)

Nëse operacioni i shkollës, përkatësisht i arsimit gjuhësor, i konceptuar si një përpjekje për të modifikuar kompetencën gjuhësore të nxënësve për t'ia arritur një kompetencë gjuhësore tjetër, të ndryshme, model, asaj të njeriut të arsimuar, që i njeh gabimet e veta dhe përpiqet t'i korrigjojë ato, ia ka arritur qëllimit deri diku në ligjërimin e shkruar, në ligjërimin e folur është ende larg realizimit. Sidoqoftë numri i folësve standardë është rritur mjaft. Këtu kanë luajtur rol dy faktorë themelorë: *diferenca e vogël tipologjike* (largësia strukturore) e *substrati dialektor dhe forca e ndryshme* në të cilën gjuha standarde është diktuar për arsye historike-sociale. Në këtë operacion shkolla është ndihmuar dhe fuqizuar edhe nga faktorë të tjerë siç janë radioja dhe televizioni që japin pa ndërprerje modele të reja sjelljesh dhe bashkë me të edhe të gjuhës së të rinjve. (Ymeri, 55)


Për këtë arsye hetimi ynë do të mbetet në kufijtë e interpretimit të të dhënave në dritën e tendencave të dukshme ose të fshehta të një anketimi të kryer në opinionet e studentëve për raportin gjuhë standarde - dialekt, për të përcaktuar lidhjet ekzistuese midis zgjedhjes së kodit gjuhësor dhe faktorëve jashtë gjuhësorë kanë ndikuar, si dhe për të marrë të dhënat për ligjërimin e folur nga e folura e tyre spontane .

Është konstatuar se vitet e fundit rinia shqiptare në RMV respektivisht studentore të cilët studiojnë nëpër universitete të ndryshme të vendit fare pak ose aspak nuk e përdorin gjuhën standarde shqipe, për ta argumentuar këtë problematikë ne bëmë një studim - anketë nga tri universitetet ku mësojnë studentë shqiptare nga qytete të ndryshme të RMV-së dhe u shfaq kjo pasqyrë e komunikimit të studentëve mes tyre; me familjen dhe shoqërinë më të gjerë.

ANKETIMI I RAPORTIT GJUHË STANDARDE E FOLME URBANE


I. Të dhëna personale

		UNIVERSITETI		
		UEJL	USHT	Shën “CIRILI DHE METODI”
KREJT	100	60	35	5




2) Vendi

Tetovë	Gostivar	Dibër	Shkup	Kumanovë	Strugë	Ohër	Kërçovë
55	20	5	5	6	3	4	2




3) Sa vjeçar jeni ?

Mosha	19	20	21	22	23
	25	60	9	5	1




4) Gjinia

Mashkuj	56
Femra	44
Gjithsej	100



5) Arsimi i prindërve.

Arsimi i prindërve	Meshkuj	femrat
Fillor	30	25
I mesëm	20	14
I lartë	6	5




Kur flasim për arsimimin e shoqërisë shqiptare në RMV na rezulton se mbi 55% janë me arsim fillor ky indikacion na bën të kuptojmë se kemi të bëjmë dendur me problematikën e gjuhës popullore e cila gjithandej është ende shumë e shprehur në mesin e shoqërisë sonë.

1. Ju flisni në dialekt apo në gjuhën standarde?

Flasi në:	m	f	Krejt
gjuhën standarde	13	12	25

Dialect	43	32	75
Krejt	56	44	100




Nëse bëjmë një krahasim të gjuhës standarde me dialektin në formën e zbatuar në shoqëri ajo qëndron në një proporcion joekuivalent në raportin gjuhë standarde - dialekt, ku na rezulton se pjesa dërmuese komunikojnë në dialekt edhe atë rreth 89% e shoqërisë sonë dhe vetëm 11% komunikojnë në gjuhën standarde.

1.1. A flisni në gjuhën standarde kudo dhe gjithmonë ?

Flasi në:	m	f	Krejt
Po	15	15	30
Jo	41	29	70
Krejt	56	44	100

KOMUNIKIMI I GJUHES STANDARDE



Në pyetje se a flasin ata në gjuhën standarde kudo dhe gjithmonë PO janë përgjigjur 90% e studentëve dhe vetëm 10% jo kjo na bën të kuptojmë njëherë e mirë se tek shqiptarët e Maqedonisë së Veriut dialekti është shumë i shprehur kundrejt gjuhes standarde që vetëm me raste flitet.

1.2. A flisni në dialekt kudo dhe gjithmonë ?


Flasi në:	m	f	Krejt
Po	50	39	89
Jo	6	5	11
Krejt	56	44	100



Nga kjo nënpyetje kuptojmë se dialekti nuk bën ndonjë pengesë për të komunikuar lirshëm në shoqërinë tonë.


2. A flitet në dialekt në familjen tuaj ?

Në familje flasim:	m	f	Krejt
Dialekt	56	44	100
Gjuhë standarde	/	/	/
Të dyja	/	/	/
Krejt	56	44	100



2.1. Si flisni me prindërit ?


Me prindërit flas në:	m	f	Krejt
dialekt	51	41	92
gjuhë standarde	/	/	/
Të dyja	5	3	8
Krejt	56	44	100



Përsëri kthehemi te konstatimi paraparak se niveli i ulët i shkollimit të prindërve rezulton tek përqindja e lartë e komunikimit dialektor mes të rinjve në Repiblikën e Maqedonisë së Veriut respektivisht pjesën veriperendimore të vendit.

3. A përbën dialekti pengesë në marrëdhëniet tuaja ?


	m	f	Krejt
Po			
Jo	56	44	100
Krejt			



Pra dialekti nuk bën asnjë pengesë në shoqërinë tonë pasi që vërejtëm se është variant i preferuar i të folurit të kësaj shoqërie.

4. A do t’ju pëlqente të mësonit një dialekt tjetër ?


	m	f	Krejt
Po	5	6	11
Jo	51	38	89
Krejt	56	44	100



Nga ky hulumtim na rezulton se të rinjtë nuk preferojnë të mësojnë dialekt tjetër edhe atë në shkallë prej 77% ndërsaq 23% do të donin të mësonin një dialekt tjetër.


4.1. Nëse po, për çfarë arsye ju pëlqen ? (rretho atë që mendon)

	m	f	Krejt
Për tu marrë vesh më mirë me të tjerët	2	3	5
Për tu zbavitur duke u tallur me të tjerët	10	7	17
Për të thënë barcoleta	6	8	14
Sepse është mirë të dish gjuhën e origjinës	23	8	31
Për tu grindur	15	18	33



Nga ky konstatim na doli se një pjesë e madhe e të rinjve dëshirojnë të mësojnë dialektin e tjetrit për tu grindur, dhe 31% për të njohur më mirë gjuhën e origjinës.


5. A duhet dialekti të mësohet në shkollë, të favorizohet nga ajo, apo të pengohet.



Edhe pse sipas hulumtimit na rezultoi që të rinjtë komunikojnë më së shumti në dialekt ata janë të vetëdijshëm se gjuha për të komunikuar në mes veti të gjithë shqiptarët është gjuha standarde dhe në këtë pyetje rezultoi negativisht nëse do të duhej të favorizohej gjuha dialektore duke e ditur se dialekti të izolon me shoqërinë më të gjerë.

6. Si flisni me shokët e fakultetit ?


Me shokët e fakultetit flasin:	Meshkuj	Femra
Dialekt	40	35
Gjuhë standarde	11	6
Të dyja	5	3



Pra edhe këtu shihet njëjtë si pyetjet e më parshme se në komunikim ndër studentor gjuha dialektore gjithmonë është primare edhe atë në shkallë deri 75%.

7. Si flasin shitësit e lagjes ?


Shitësit e lagjes flasin:	Meshkuj	femra
Dialekt	54	40
Gjuhë standarde	1	3
Varet	1	1



Pra në përgjithësi shoqëria shqiptare e Maqedonise së Veriut, përdor gjuhën dialektore.

7.1.Si u drejtohesh ti ?


Studentët me shitësit flasin:	Meshkuj	femra
Dialekt	53	40
Gjuhë standarde	2	3
Varet	1	1



Niveli i ulët i shkollimit ndoshta logjikisht i shtyn studentët që në lagje të tyre të komunikojnë në gjuhën e shitësit.

8. Nëse nuk flisni në dialekt tregoni arsyen. Pse?

	MESHKUJ	FEMRA
Flasin në dialect	52	41
Nuk flasin në dialect	2	3
Nuk janë përgjigjur	2	2



Ky rezultat tregon hapur dhe qartazi se në këto troje është shumë e shprehur gjuha e të rinjve.

Konkluzionet e anketimit

Nga ky anketim erdhëm në përfundim se pjesa dërmuese e studentëve gjatë të folurit si mjet shprehës shfrytëzojnë dialektin e tyre prej nga ata vijnë, kështu që dialektit i jepet hapësirë në masë të madhe edhe në shoqërinë më të gjerë të këtyre trevave në RM, vërejmë se edhe familja mes veti flet në gjuhën dialektore pra të folmen e qytetin ose fshatit duke vazhduar edhe me fqinjët, lagjen, e deri në insitucionet shkollore ku për fat të keq është shumë i shprehur komunikimi dialektor, sipas mendimit tonë duhet të merren masa plotësuese nga organet kompetente institucionale që të stimulohet rinia drejt gjuhës standarde të paktën nëpër institucionet e dijes dhe të fillojnë të favorizojnë gjuhën standarde, për atë të cilën tani më janë përcaktuar si intelektualë të ardhshëm, të ndjekim hapat e të rinjve në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut e gjetiu për një gjuhë më të favorshme për komunikim kombëtar siç është tanimë gjuha jonë e standardizuar.

Gjatë anketimit që iu bë studentëve nga qytete dhe universitete të ndryshme arrita të nxjerr një konkluzion për sa i përket raportit gjuhë standarde- dialekt. Sipas përgjigjeve të dhëna kuptojmë se studentët përdorin më së shumti dialektin, se sa gjuhën standarde. Por gjithsesi ata nuk e përdorin gjithmonë dialektin, ashtu siç nuk e përdorin gjithmonë gjuhën standarde. Përdorimi i pakët i gjuhës standarde vjen për shkak të rrethit ku jetojnë, pasi shumica e studentëve në familje flasin në dialekt e vetëm një pjesë e vogël e tyre flasin në gjuhë

standarde. Veç kësaj studentët parapëlqejnë të mësojnë të folmen e krahinave tjera, por nuk janë dakord me faktin që dialekti të mësohet ose të favorizohet në shkolla, pasi janë të vetëdijshëm për rëndësinë e gjuhës standarde dhe përdorimin e saj në situata të ndryshme.

- Në familje në të shumtën e rasteve flitet në dialekt për arsye se vendet prej ku vinë ata i përkasin një shtrirje gjeografike ku i gjithë rrethi flet në dialekt.
- Edhe pse preferojnë të flasin në dialekt, studentët janë kundër mësimi apo favorizimit të tij në shkollë.
- Zakonisht shumica e studentëve preferojnë që në familje ta ruajnë kulturën tradicionale duke përdorur në çdo situatë gjuhën e rrethit (dialektin).
- Një pakicë e vogël e “studentëve gjuhën standarde e shohin si një mjet të domosdoshëm për t’u paraqitur sa më denjësisht në shoqëri.
- Sipas rezultateve sociolinguistike është vërtetuar që marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve në aspektin gjuhësor dobësohet shumë, ndërsa rritet ndikimi i grupeve të moshatarëve.
- Kjo prirje të rinjtë fillon gjatë viteve të studimeve universitare.
- Një ndikim të madh në këtë aspekt kanë edhe mediet, të cilat me rubrikat e llojllojshme, janë edhe tribunë e jetës kulturore, artistike, arsimore etj. Ato janë një fushë e gjerë ku zbatohet e përpunohet gjuha letrare dhe si të tilla luajnë rol të madh jo vetëm në emancipimin e masave të lexuesve, të dëgjuesve e të teleshikuesve, por sepse ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në përhapjen dhe ngulitjen e normës letrare, duke filluar nga lexuesit e gjer te punonjësit e arsimit e të kulturës. (Nesimi 1997:29).

Njohja dhe analizimi i shkaqeve dhe problemeve

Ashtu si çdo gjuhë letrare normative ka disa veçori specifike, të cilët nuk i posedojnë gjuhët e tjera, edhe shqipen letrare të normëzuar e karakterizojnë disa veçori specifike, si: historiku i saj, baza dialektore a karakteri popullor i saj, marrëdhëniet e saja me gjuhë të tjera veçanërisht në thesarin leksikor, parimet e drejtshkrimit të saj, standardizimi policentrik i saj, normëzimi inveriabil (pa variante të trajtave) etj. (Mulaku 1989:6).

Një problem tjetër, që paraqitet është se një formë e vetme, e përbashkët e shqipes së standardizuar letrare u përket shteteve të ndryshme (Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi), kryesisht në procesin e standardizimit të gjuhës letrare, veçanërisht në

terminologjinë e disa shkencave, të teknikës e të ekonomisë, të arteve, të veprimtarisë shoqërore etj. Ndryshimet p.sh. në tekste shkollore ndodhin për shkak se e njëjta normë zbatohet në disa mjedise (ambiente) të ndryshme sociokulturore, me formacione shoqërore dhe me sisteme jo të njëllota ekonomike, politike etj.

Fenomenet e standardizimit të shqipes letrare, janë vëzhguar fare pak ose aspak. Ende nuk kemi analiza shkencore në zbatimin dhe realizimin e normës letrare shqipe në qendrat përkatëse, të caktuara kulturore, ekonomike, administrative etj. Nëse duam të bëjmë planifikim të përbashkët në standardizimin dhe kristalizimin e gjuhës letrare në arsim dhe fushat tjera , atëherë çdo zgjidhje gjuhësore që propozohet duhet t'i nënshtrohet analizës profesionale-shkencore dhe verifikimit shoqëror. Këtë duhet ta bëjnë në radhë të parë gjuhëtarët, pastaj përfaqësuesit kulturorë, intelektualët e tjerë, si dhe institucionet e caktuara shoqërore kanë detyrë kërkimore-shkencore dhe profesionale të rëndësishme. (Ibrahimi 2012:126-127).

PËRFUNDIMI

Në këtë tezë masteri arrita që sado pak të flas për një temë e cila është shumë aktuale dhe interesante për tu hulumtuar pasi ndonjë herë duke komunikuar në mënyrë elektronike as që e vërejmë veten se çfarë shkruajmë , në çfarë stili etj. Përdorimi i shenjave dhe emotikoneve sipas mendimit tim janë dicka shumë interesante pasi siç cekta edhe më lartë, diçka që nuk mund ta themi me fjalë e shprehim nëpërmes simboleve.

Gjatë anketimit arritëm edhe sado pak të qartësojmë se a kanë ndikim negativ përdorimi i shenjave dhe emotikoneve , cilat mosha i përdorin, a e dëmtojnë gjuhën, arsyjet përse i përdorin. Shenjat dhe emotikonet përdoren nga të gjithë grupmoshat, ata e dëmtojnë gjuhën mendoj që nuk por ndonjëherë ato na ndihmojnë që të komunikojmë më shpejt dhe e bëjnë komunikimin më të lehtë.Gjuha është mjet themelor më i përsosur për komunikim mes njerëzve. Ajo mund të materializohet në dy mënyra: me të folur dhe me të shkruar. Në zhvillimet teknologjike në fushën e komunikimit më tepër përdoret gjuha e shkruar se sa gjuha e folur. Pas vitit 1992,interneti pati një përhapje dhe shtrirje marramendëse nëpër botë, duke u zhvilluar dhe përsosur edhe më tepër.

Funksionet e tij u zgjeruan, duke mundësuar shkëmbimin e informatave dhe komunikimin në të gjitha format. Sistemet e ueb faqeve, të email-ve, të bashkëbisedimit në grupe dhe veç e veç (chat), sistemet e mesazheve të çastit (instant messenger) etj. Thelbi kryesor i këtij punimi është fjalët më të përdorura në komunikimet elektronike dhe fjalët e shkurtuara. Sa i përket Kreut të parë në rrafshin e gjuhës shqipe, interneti ka pasur po të njëjtin ndikim, sikurse edhe në gjuhët e tjera. Ai i ka hapur rrugë variacionit gjuhësor të shqipes, duke e mundësuar përdorimin e varieteteve të tjera dialektore e shoqërore të shqipes, krahas gjuhës standarde, e cila, në internet, përdoret kryesisht në ueb faqet e institucioneve qeveritare e publike dhe në ueb faqet e medieve në gjuhën shqipe.

Për më tepër, shqipja ka gjetur përdorim në të gjitha aktivitetet në internet, sidomos në format e komunikimit të ndërmjetuar me kompjuter (CMC). Ajo sot përdoret në dhomat e ndryshme për bisedime (chat rooms), në komunikimin me mesazhe të çastit në mesenxherë (messenger instant messaging) etj. Ky përdorim ka ndikuar në krijimin e formave të qëndrueshme gjuhësore të cilat përdoren në komunikimin e ndërmjetuar me kompjuter. Këto forma i kanë tiparet dhe karakteristikat e tyre, në bazë të të cilave mund të flitet për varietete të posaçme gjuhësore të shqipes të përcaktuara për përdorim në dhoma të bisedave e mesenxherë.

Në Kreun e dytë shohim se gjuha që përdoret në komunikime elektronike, veçanërisht në Mesenxher, SMS, WhatsApp dhe Viber, nuk është një gjuhë standarde, mirëpo është një gjuhë e mbushur përplot me fjalë dialektore, leksikore, krahinore e të tjera, varësisht nga kush përdoret dhe ka mjaftë gabime, duke filluar nga gabimet drejtshkrimore, fonetike, morfologjike dhe sintaksore. Kemi një numër të madh të përdorimit të fjalëve që nuk i përkasin gjuhës standarde, fjalët janë të shkruara në Kreun e dytë, të cilat janë hasur nga një grup njerëzish.

Në Kreun e dytë dhe të tretë njerëzit që janë intervistuar, që përdorin komunikimet elektronike në këtë punim gjithsej janë: 200 persona 100 femra dhe 100 meshkuj. Kreu i tretë i cili ka të bëjë me përdorimin e fjalëve të shkurtuara në komunikimet elektronike siç janë: Mesenxher, SMS, WhatApp dhe Viber dhe në disa rrjete sociale. Mbledhja e fjalëve është bërë nga një periudhë të caktuar kohore nga një numër icaktuar i të intervistuarve që në detaje i kemi në Kreun e tretë.

Nga të gjithë fjalët e shkurtuara më tepër është përdorur fjala **flm** pastaj fjala **klm** , **td** dhe **tf**, natën, ntm, tdsh zmr, dns, tel, sps dhe nr

Kreu i katërt përmban shenjat, simbolet dhe shkurtime onomatopeike, që janë të përhapura në masë të madhe në komunikime elektronike dhe shenjat më të përdorura janë: :) - buzëqeshje, :(- pikëllim etj. Nga këto të dhëna vërejmë se të gjithë të anketuarit e përdorin shenjën :) – *buzëqeshje*, :* - *puthje*, <3 – *zemër* :(- *pikëllim*;) – *shkelje esyrit* dhe :D – *gojëhapur* :P – *nxjerrje e gjuhës* dhe :-) – *më vjen mirë*. Kreu i fundit përmban mesazhe që janë hasur në internet dhe telefona celularë me përmbajtje dashurie, mesazhe urimi, mesazhe talljeje, mesazhe për lëndët mësimore etj. Këto mesazhe mund të futen edhe në folklorin e gjuhës dhe të njihen si folklor elektronik, që përdoren nga të rinjtë. Kjo fushë është shumë pak e hulumtuar dhe ka nevoja të mëdha që të bëhen hulumtime në këtë fushë. Një numër i madh i këtyre mesazheve që mund t'i gjejmë në internet, duke përfshirë rrjete të ndryshme sociale si: *Facebook, Skype, Tango, Twitter, Mesenxher, Sms, Viber, WhatsApp* e të tjera dhe forume të ndryshme shoqërore, duhet të mblidhet dhe të ruhen sepse me të vërtetë është një pasuri e folklorit elektronik dhe nëse në këtë fushë nuk merret asnjë hap për ruajtjen e këtyre mesazhe, mund të vijë deri te zhdukja e tyre.

Nëse këto mesazhe mblidhen dhe ruhen, atëherë me të vërtetë në këtë fushë mund të hapen drejtime të shumta për të studiuar dhe jo vetëm që do e pasurojnë folklorin elektronik, por edhe do të ndihmojnë në ruajtjen e gjuhës dhe më lehtë mund të vërehen gabimet që ndodhin gjatë shkrimeve elektronike. Në përmbyllje, të shtojmë se interneti është duke pasur një ndikim të fuqishëm jo vetëm si mjet për shkëmbimin e informatave, por edhe në kuptim të ndryshimeve shoqërore që është duke shkaktuar. Interneti e ka revolucionarizuar edhe komunikimin gjuhësor duke i dhënë dimensione të reja dhe në kuadër të këtij revolucioni komunikues, edhe gjuha shqipe është duke e gjetur vendin e saj.

Nga shembujt që u dhanë më lart, del se komunikimi në dhomat e bisedave (chat) dhe komunikimi me mesazhe çasti në mesenxherë tashmë ka krijuar formula të qëndrueshme të përdorimit të gjuhës, pra edhe të gjuhës shqipe. Përveç ndryshimit të fjalëve, në gjuhën e bisedave të çastit janë futur edhe fjalë të huaja, siç përmendëm më lartë fjalët angleze që dominojnë, shenjat dhe simbolet që janë çdoherë të pranishme në komunikime elektronike. Si përfundim duhet që të merren masa për ruajtjen e gjuhës, mos vijë deri te dëmtimi i saj, sepse sa më tepër që përdoren komunikimet elektronike, aq më tepër gjuha pëson ndryshime dhe deri në ditët e sotit gjuha jonë ka mjaftë ndryshime nëse e krahasojmë me vitet e mëparshme.

Nga shqyrtimi i përgjigjeve të studentëve mund të nxirren disa konsiderata të rendit sociolinguistik: E dimë se gjuha është pasqyra e kulturës së një kombi. Çështjet e kulturës së gjuhës në përgjithësi dhe të zbatimit të normës letrare në veçanti, pa vënë në dyshim arritjet e

mëparshme. Të rinjtë që studiojnë në Tetovë e që janë nga qytete të ndryshme, shumë pak mundohen ta përdorin gjuhën standarde, edhe pse nuk bien në kontakt për herë të parë. Në përpjekjen e tyre për të folur gjuhën letrare pa interferenca dialektore studentët priren të modifikojnë dhe shqiptimin. Ato kanë një prestigj të ulët nga pikëpamja e kulturës dhe arsimit

LITERATURA

- Brame, Olger** (2014). *Gjuha e të rinjve në rrjetet sociale si një aspekt sociolinguistik i komunikimit*. Në Konferenca II Ndërkombëtare” Gjendja dhe perspektiva e sociolinguistikës sot” (1 nëntor 2013). UEJL, Tetovë
- Saliu, Zurijeta** (2014). Përdorimi i simboleve dhe shenjave në komunikimet elektronike. Në Konferenca II Ndërkombëtare” Gjendja dhe perspektiva e sociolinguistikës sot” (1 nëntor 2013). UEJL, Tetovë
- Bakiu, Donika**. (2017, 8 22). *www.infoshqip.com* . Retrieved 11 7, 2018, from <https://www.infoshqip.com/interneti-dhe-te-rinjte-vaesia-dhe-rreziket/>
- Bakiu, Donika**. (2019). Gjuha e të rinjve në rrjetet sociale. *Albanologjia 11-12*, f.240.
- Sidheri, E. (2019, 10 5). *Kemi harruar vallë të shkruajmë me dorë?* Retrieved 11 2, 2019, from shekullionline: <http://shekulli.com.al/kemi-harruar-valle-te-shkruajme-me-dore/>
- Bejta, Murat** (redaktor). (1988). *Fjalor i fjalëve të huaja*. Rilindja. Prishtinë.
- Crystal, David**. (1999). *Interlanguage on the Internet*. Në internet: [http://www.davidcrystal.com/DC articles/Internet5.pdf](http://www.davidcrystal.com/DC%20articles/Internet5.pdf), qasja për herë të fundit më 4 mars 2009.
- Crystal, David**. (2001). *Languages on the Internet*. Lingua Franca, March, ABC, në Internet: [http://www.davidcrystal.com/DC articles/Internet11.pdf](http://www.davidcrystal.com/DC%20articles/Internet11.pdf), qasja për herë të fundit më 4 mars 2009.
- Crystal, David**. (2001). *Weaving a Web of linguistic diversity*. Në Internet: [http://www.davidcrystal.com/DC articles/Internet6.pdf](http://www.davidcrystal.com/DC%20articles/Internet6.pdf), qasja për herë të fundit më 25 janar 2001.
- Crystal, David**. (2005). *The scope of Internet Linguistic*. Paper given online to the American Association for the Advancement of science meeting, February, në Internet: [http://www.davidcrystal.com/DC articles/Internet2.pdf](http://www.davidcrystal.com/DC%20articles/Internet2.pdf), qasja për herë të fundit më 4 mars 2009.
- Цвјетићанин, Тијана**. (2006). *Електронски фолклор тинејџера: SMS поруке*. Гласник Етнографског института САНУ LIV, br. 54, str. 113-125. Београд.
- Çepani, Anila**. (2006). *Problemet e kulturës së gjuhës në përdorimin e shqipes në internet*. Në Seminari XXV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 25/1. Prishtinë.
- Dajo, Stavri**. (12.11.2012). *Gjuha e mesazheve elektronike të telefonisë celulare*. Në gazetën “Tribuna”. Greqi.
- Drinčić, Goran**. (2012). *Elementi neverbalne komunikacije u jeziku internet: diskurs*

ceta. Në “Mi o jeziku, jezik o nama”, zbornik radova sa druge konferencije drustva za primijenjenu lingvistiku. Slavicca Perovic. Crne Gore.

Gega - Musa, Leontina. (2012). *Interferencat e dy formave të shkurtra të letërsisë gojore*. Në revistën shkencore të Institutit Alb – Shkenca, vëll. Nr. 4, 2012. Tiranë – Shkup – Prishtinë. F:672-676.

Hamiti, Mentor & Ibrahim, Mustafa. (2006). *Denduria e përdorimit të fonemave zanore e bashkëtingëllore në tekstet e botuara shqipe në Maqedoni*. UEJL. Tetovë.103

Hudson, Richard A. (2002). *Sociolinguistika*. Cambridge University Press.

Hristova - Bejleri, Rusana. (2006). *Gjuha shqipe dhe teknologjitë e informacionit*.

Në internet: http://264517.forumromanum.com/member/forum/forum.php?action=std_show&entryid=1094044043&USER=user_264517&threadid=2, / 6 shkurt 2006.

Ibrahimi, Mustafa. (2012). *Tema socilinguistike dhe etnolinguistike*. Interlingua. Shkup.

Ibrahimi, Mustafa, Behxheti, V., Xhaferi, H. & Kadriu, Z. (2008). *Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni*. UEJL. Tetovë.

Ibrahimi, Mustafa. (2018). *Sociolinguistika*. UNT, Shkup.

Ismajli, Rexhep. (1977). *Ferdinand de Saussurei dhe gjuhësia moderne*. Prishtinë.

Islamaj, Shefkije. (2009). *Për një korpus kulturor dhe për një korpus gjuhësor në internet*. Në Internet: <http://www.kosovarimedia.com/index.php/biblioteka/studimeper-gjuhen/550-per-nje-korpus-kulturor-dhe-per-nje-korpus-gjuhesor-ne-internetdrshefkije-islamaj.html>, qasja për herë të fundit më 3 tetor 2009.

Lyons, John. (2001). *Hyrje në gjuhësinë teorike*. Dituria. Tiranë.

Munishi, Shkumbin. (2006). *Gjuha standarde shqipe në Kosovë dhe drejtimet e zhvillimit të saj*. (Disertacion i doktoraturës). Universiteti i Prishtinës. Prishtinë.

Munishi, Shkumbin. (2013). *Gjuha, kombi dhe identiteti të shqiptarët*. Prishtinë. Në Internet: <http://linguasocio.blogspot.com/2013/01/gjuha-kombi-dhe-identiteti-teshqiptaret.html>, qasja për herë të fundit 16 janar 2013.

Munishi, Shkumbin. (2009). *Gjuha shqipe dhe internet*. Në “Filologji”, nr. 16. Prishtinë.

Munishi, Shkumbin. (2008). *Gjuha standarde dhe variacioni sociolinguistik*.

Prishtinë. Në Internet: <http://linguasocio.blogspot.com/2008/05/gjuha-standarde-dhe-variacioni.html>, qasja për herë të fundit më 21 maj 2008.

Paçarizi, Rrahman. (2006). *Gjuha e mesenxherit*. Në “Filologji”, nr.14. Prishtinë.

Sapir, Eduard. (1980). *Gjuha- hyrje në studimin e ligjërit*. Rilindja. Prishtinë.

- Spinnen, Burkhard & Verbica, Angjelina.** (2012). *Interneti përhap fjalë të reja – gjuha ruan të domosdoshmet*. Në Internet: www.dw.de/internet, qasja për here të fundit më 4 mars 2012.
- Stefanllari, Ilo.** (1988). *Fjalor Anglisht – Shqip*. Rilindja. Prishtinë.
- Vainshtein, Olga.** (1996). *Contemporary notebooks of love: girls' subculture in Russia*. Paper given at the conference „Private life in Russia“, University of Michigan, Ann Arbor, October 1996. Në Internet: <http://www.ruthenia.ru/folklore/veinstein2.htm>, qasja për here të fundit 17 tetor 2001.
- Grup autorësh.** (Hamiti, Sabri, Shala, Kujtim, Idrizi, Xhemaludin, Aliu, Ali & **Metani, Idriz.** (2009). *Gjuha shqipe dhe letërsia I*. (Për gjimnazet e reformuara). Albas. Tiranë - Prishtinë – Tetovë.
- Priracnik za nastavnici za izucuvanje na mediumskata pismenost vo nastavata po majcin jazik. Makedonski institut za medium i institute za demokratija “Societas Civilis” . Skopje. 2010. f-1.
- Bejta, Murat** (redaktor). (1988). *Fjalor i fjalëve të huaja*. Rilindja. Prishtinë.
- Çepani, Anila.** (2006). *Problemet e kulturës së gjuhës në përdorimin e shqipes në internet*. Në Seminari XXV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 25/1. Prishtinë.
- Drinčić, Goran.** (2012). *Elementi neverbalne komunikacije u jeziku internet: diskurs ceta*. Në “Mi o jeziku, jezik o nama”, zbornik radova sa druge konferencije drustva za primijenjenu lingvistiku. Slavicca Perovic. Crne Gore.
- Dajo, Stavri.** (12.11.2012). *Gjuha e mesazheve elektronike të telefonisë celulare*. Në gazetën “Tribuna”. Greqi.
- Ibrahimi, Mustafa.** (2012). *Tema socilinguistike dhe etnolinguistike*. Interlingua. Shkup.
- Ibrahimi, Mustafa, Behxheti, V., Xhaferi, H. & Kadriu, Z.** (2008). *Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni*. UEJL. Tetovë.
- Nesimi, Remzi:** *Çështje gjuhësore*, “Shkupi”. Shkup 1997.
- Shkurtaaj, Gjovalin – Memushaj, Rahmi** (Shkurtaaj-Memushaj 1998): *Shkolla dhe shqipja letrare*. "Gjuha jonë", nr.1-4/1998, Tiranë, f.56-63.
- Shqipja standarde dhe shoqëria sot*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Shkenca” Tiranë 2003.
- Ymeri, Mariana :** *Raportet gjuhë standarde-dialekt në opinionet e studentëve : të dhëna për standardizimin e ligjërit të folur*. Gjuha Jonë, 13/1-4, 1993, 52-65.

SHTOJCA

ANKETIMI 1

1. Gjinia

- a) mashkullore
- b) femrore

2. Cilët mosha i përdorin më tepër (pra të tregoj se cili sa vjet ka)?

3. Pse përdoren shenjat dhe simbolet në internet?

- a) Është më i lehtë komunikimi
- b) Për të komunikuar shpejtë
- c) Tregojnë ndjenja

4. A përdoren shpesh?

- a) Po
- b) Jo

5. Cilat simbole i përdorni mëshumë?

- :) – buzëqeshje
- ;) – shkelje e syrit
- :D – gojë hapur
- :(- pikëllim
- :P – nxjerrje e gjuhës
- :-) më vjen mire
- <3 zemer
- :* - puthje e zjarrtë

6. A mendoni ti përdorni edhe në të ardhmen?

- a) Po
- b) Jo

7. A dëmtohet gjuha me përdorimin e shenjave?

- a) Pak
- b) Shumë
- c) Aspak

ANKETIMI 2

I. Të dhëna personale

	UNIVERSITETI		
	UEJL	USHT	Shën “QIRIL DHE METODI”
KREJT			

2) Vendi

Tetovë	Gostivar	Dibër	Shkup	Kumanovë	Strugë	Ohër	Kërçovë

3) Sa vjeçar jeni ?

Mosha	19	20	21	22	23

4) Gjinia

Mashkuj	
Femra	
Gjithsej	

5) Arsimi i prindërve.

Arsimi i prindërve	
Fillor	
I mesëm	
I lartë	

1. Ju flisni në dialekt apo në gjuhën standarde?

Flasi në:	m	f	Krejt
gjuhën standarde			
dialekt			
Krejt			

1.1. A flisni në gjuhën standarde kudo dhe gjithmonë ?

Flasi në:	m	f	Krejt
Po			
Jo			
Krejt			

1.2. A flisni në dialekt kudo dhe gjithmonë ?

Flasi në:	m	f	Krejt
Po			
Jo			
Krejt			

2. A flitet në dialekt në familjen tuaj ?

Në familje flasim:	m	f	Krejt
Dialekt			
Gjuhë standarde			
Të dyja			
Krejt			

2.1. Si flisni me prindërit ?

Me prindërit flas në:	m	f	Krejt
dialekt			
gjuhë standarde			
Të dyja			
Krejt			

3. A përbën dialekti pengesë në marrëdhëniet tuaja ?

	m	f	Krejt
Po			
Jo			
Krejt			

4. A do t'ju pëlqente të mësonit një dialekt tjetër ?

	m	f	Krejt
Po			
Jo			
Krejt			

4.1. Nëse po, për çfarë arsye ju pëlqen ? (rretho atë që mendon)

	m	f	Krejt
Për tu marrë vesh më mirë me të tjerët			
Për tu zbavitur duke u tallur me të tjerët			
Për të thënë barcoleta			
Sepse është mirë të dish gjuhën e origjinës			
Për tu grinder			

5. A duhet dialekti të mësohet në shkollë, të favorizohet nga ajo, apo të pengohet.

Dialekti në shkollë duhet:	
Të mësohet	
Të pengohet	
Të favorizohet	

6. Si flisni me shokët e fakultetit ?

Me shokët e fakultetit flasin:	
Dialekt	
Gjuhë standarde	
Të dyja	

7. Si flasin shitësit e lagjes ?

Shitësit e lagjes flasin:	
Dialekt	
Gjuhë standarde	
Varet	

7.1.Si u drejtohesh ti ?

Studentët me shitësit flasin:	
Dialekt	
Gjuhë standarde	
Varet	

8. Nëse nuk flisni në dialekt tregoni arsyen. Pse?

Flasin në dialekt	
Nuk flasin në dialekt	
Nuk janë përgjigjur	

Kush e kreu anketën (Emri dhe mbiemri): _____

Data e anketimit: _____